

LE MONDE. *shqip* diplomatique

Nr. 801 / Viti i 67 i botimit / Janar - Shkurt 2021

ARTA DADE, ISH-MINISTRE E JASHTME E SHQIPËRISË

Shqipërisë i mungon një e majtë sociale



INTERVISTOI: ARDIT RADA

Përmes një interviste të rrallë, ish-ministrja e Punëve të Jashtme të Shqipërisë rikthehet për publikun ku rrëfen qëndrimet e saj mbi zhvillimet e fundit në rajon. Arta Dade shprehet se i takon Shqipërisë si vendi amë që ta ndihmojë Kosovën me përvojën e saj në proceset integruuese, por edhe me zbatimin e marrëveshjeve dhe duke krijuar lehtësira për qytetarët e saj. Për 'Le Monde Diplomatique' në gjuhën shqipe, Dade komenton edhe marrëdhëniet Kurti-Rama, apo ndikimin që pritet të ketë administrata Biden në faktorin shqiptar. Por, a do të rikthehet zonja Dade në politikën aktive? Ish-ministrja sqaron më poshtë ambiciet e saj, si dhe eksperiencën në krye të MPJ. /Faqe 7-8

KUR BALLKANIZIMI FAVORIZON KLANIZMIN

Klientelizmi dhe identitetet e trazuara në Malin e Zi



Për herë të parë në historinë e tij, Mali i Zi po përjeton ndryshim pushteti përmes kutive të votimit. Nën drejtimin e z.Milo Gjukanoviq, ekipi në ikje ka qenë në mënyrë të njëpasnjëshme komunist, nacionalist panserb, rusofil; separatist, e pastaj atlantist dhe pro-evropian...Mazhoranca e re nuk i ikën dot logjikave të identitetit ose presioneve të jashtme që imponojnë një kornizë të ngushtë për rinovimin e pritshëm.

NGA TË DËRGUARIT TANË SPECIALE
PHILIPPE DESCAMPS DHE ANA OTAŠEVIC*

Për ta përballuar të ftohtin thumbues në fund të tetorit në një lartësi prej më shumë se 1700 metrash, militantët u mbledhën rreth një zjarri të madh. Ndodhemi në pllajën Sinjajevina, një Larzac i ri në malet e Malit të Zi verior. Ashtu si në pllajat

franceze në mesin e viteve 1970, popullsia lokale, e mbledhur nga ambientalistët, kanë frikë se këto kullota të shkëlqyera do të shndërrohen në tokë ushtarake.

“Qeveria në ikje dëshironte që kjo zonë e liqenit Savina Voda të

shërbente si fushë për manovrim dhe shkatërrim të municioneve të vjetëruara”, shpjegon Milan Sekuloviq, themelues i iniciativës së qytetarëve Sauvons Sinjajevina në 2018. Fermat e rreth pesëdhjetë familjeve u kërcënuan, kur numri i fshatarëve vazhdoi të ulet

për mungesë të ndihmës publike, investime në rrugë ose në energji elektrike. « Vendi ynë importon 80% të ushqimit të tij, ndërkohë që mund të zhvillojmë blegtori dhe vetëfurnizim ». /Faqe 5-6

Editorial

“Heshtni !”

Nga Serge Halimi

/ Faqe 4

Debat

Pikëpyetjet e përmbysjes së madhe ‘catch-all’

Intervistoi: Shkodran Hoti /Faqe 2-3-4

Fitorja plebishitare e Lëvizjes Vetëvendosje së Albin Kurtit dhe Listës së Vjosa Osmanit në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë është komentuar edhe si një revolucion elektoral kundrejt partive “tradicionale” (PDK, LDK, AAK,

Bisedë

Serbët dhe shqiptarët kanë më shumë histori bashkëjetese sesa konflikti

Intervistoi: Vukashin Obradoviq /Faqe 12-13

Secili në mënyrën e tij, Marko Miljanov dhe Dimitrije Tucoviq, dy figura të rëndësishme publike serbe, dikur kundërshtuan histerinë

Gjeopolitikë

Idila midis vendeve të Gjirit dhe Izraelit

Nga Akram Belkaid /Faqe 14

Më 23 tetor, pas disa muajsh diskutimesh dhe ndërmjetësimi të SHBA, Izraeli dhe Sudani u pajtuan të krijojnë marrëdhënie diplomatike. Kjo marrëveshje pasoi ato të arritura midis Tel Avivit dhe dy monarkive të Gjirit, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreini, me

Teatër

Pasolini ose refuzimi i përshtatjes

Nga Olivier Neveux /Faqe 17

Ibërë publik për herë të parë më 1968, me rastin e shfaqjes së tij ‘Orgji’, ‘Manifesti për një Teatër të Ri’ i Pier Paolo Pasolini ishte botuar vetëm pjesërisht në Francë. Shtëpia botuese ‘Ypsilon’ mundësoi an njohjen e tërë veprës së tij.

KOSOVA PAS FITORES PLEBISHITARE TË DUETIT KURTI-OSMANI

Pikëpyetjet e përmbysjes së madhe ‘catch-all’

Lista e përbashkët e Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit arriti të fitoi më shumë vota se krejt partitë e tjera shqiptare të Kosovës, duke përfshirë brenda saj të gjitha bindjet ideologjike. Një “revolucion” i tillë zgjedhor ngrit jo pak pikëpyetje mbi orientimet e ardhshme të pushtetit dhe opozitës së re.

INTERVISTOI: SHKODRAN HOTI



Fitorja plebishitare e Lëvizjes Vetëvendosje së Albin Kurtit dhe Listës së Vjosa Osmanit në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë është komentuar edhe si një revolucion elektoral kundrejt partive “tradicionale” (PDK, LDK, AAK, NISMA) të cilat qeverisen bashkë ose ndarazi për pothuajse 20 vjet pas luftës. Përderisa kauza ishte fundi i keqeverisjeve dhe lufta kundër korrupsionit, pak syresh e trajtuan procesin nga aspekti ideologjik. Se ç’nënkupton politikisht fitorja kaq e thellë zgjedhore e listës së përbashkët të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit dhe ç’do të mund të prodhojë ajo nga kuptimi i profilizimit të ardhshëm ideopolitik të skenës vendore politike, bashkëbiseduam me Blerim Latifin, ligjërues i filozofisë politike në Universitetin

e Prishtinës; si dhe Zgjim Hyseni, nënkryetar i Partisë Socialdemokrate.

– Kosova sapo ka dalur nga një proces zgjedhor, në të cilat fituese ka dalë Lëvizja Vetëvendosje, që brenda listës kishte përfshirë Listën e Vjosa e Osmanit, Alternativën e MIMOZA Kusarit, por edhe individë që vetëcilësohen si të djathtë. Kjo listë shënoi fitore pothuajse plebishitare. Ç’nënkupton për juve ky rezultat zgjedhor në kuptimin ideologjik?

Blerim Latifi: Lëvizja Vetëvendosje është shndërruar në një ‘catch-all party’, në një parti që synon të mbledhë njerëzit e të gjitha bindjeve ideologjike. Kjo është bërë me qëllim që të sigurohet një fitore e madhe elektorale dhe në

këtë pikëpamje Lëvizja Vetëvendosje ia ka arritur qëllimit. Kjo mund të shpjegohet me faktin se Kurti ia ka dalë që të gjitha llojet e pakënaqësive që janë shfaqur në vitet e fundit në Kosovë, qofshin ato individuale apo grupe, t’i integrojë në rrëfimin e tij politik, duke i bindur të gjithë të pakënaqurit e të gjitha ngjyrave se ai është rrugëzgjidhja për të gjitha brengat e tyre. Kjo lloj metode politike e mobilizimit të mbështetësve njihet si populizëm inkluziv, i cili nënkupton mbledhjen e të gjitha llojeve të pakënaqësisë sociale në një kauzë të madhe e cila operon me termat moral të mirës dhe së keqës dhe përmes reduktimit të të gjitha shkaqeve të pakënaqësisë në një shkak të vetëm të madh.

“Lista që ka fituar zgjedhjet është tipike aso që sot quhen ‘catch-all’. Shtresa e pozicione krejt të ndryshme për kah kërkesat dhe sociologjia kanë votuar të njëjtin opcion. Ky është fenomeni i oportunizmit elektoral, ku secilit i bëhet qejfi në shkëmbim të votës. Si qasje, kjo është heqje dorë prej progresit dhe emancipimit” – Zgjim Hyseni

Zgjim Hyseni: Kemi të bëjmë me një amalgamë që është vështirë t’ia gjesësh fillin për ta kuptuar lidhjen. Por, qëllimi gjithsesi dihet: pushteti total. Lista që ka fituar zgjedhjet është tipike aso që sot quhen “catch-all”. Shtresa e pozicione krejt të ndryshme për kah kërkesat dhe sociologjia kanë votuar të njëjtin opcion. Ky është fenomeni i oportunizmit elektoral, ku secilit i bëhet qejfi në

shkëmbim të votës. Si qasje, kjo është heqje dorë prej progresit dhe emancipimit. A nuk do të duhej të ndryshonim të gjithë me ndryshimin e “madh”?! A nuk është ndryshimi edhe ndryshimi i dëshirave e ëndrrave, apo qenka thjesht kënaqje e tyre?! Në fakt secili përparim, secila hapje e perspektivës është tejkalim i partikularitetit drejt gjetjes së ekuivalencave me grupet e tjera shoqërore. Lista “Krejt dhe Drejt” është saktësisht e kundërta e kësaj. Aty kemi çorbë ideologjike, por edhe betonim të kërkesave e grupeve shoqërore ashtu siç ato janë, gjithmonë nën garancën e madhe historike të “liderit suprem”.

– Çfarë orientimi ideologjik pritni nga Qeveria Kurti2?

Blerim Latifi: Kurti ka



BLERIM LATIFI

bindje të qarta majtiste. Unë presqëaitëpërpiqettëjetësorj shumë nga idetë politike që i përkasin provincës së socialdemokracisë, por Kurti nuk është thjeshtë socialdemokrat, ai është edhe njëloj nacionalisti i majtë që konsideron se pavarësia kombëtare dhe drejtësia sociale janë dy gjëra që nuk mund të ndahen nga njëra tjetra. Duke qenë një nationalist i majtë, ai do të përpiqet të demonstrojë njëloj politike autonome në raport me presionet ndërkombëtare dhe në këtë rrafsh mbase edhe duhet të priten tensione midis qeverisë së tij dhe partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës, të tilla siç i patëm parë në qeverinë e tij të parë, ndërsa në rrafshin e brendshëm pres që Kurti të angazhohet në një vendimmarrje e cila do të ketë për target grupet të cilat ai i sheh si klientela të pasurara përmes abuzimit me pushtetin. Ai do të përpiqet shumë që të krijojë njëloj sensi të drejtësisë sociale në shoqërinë kosovare. E them këtu nisur nga fakti se i merr shumë seriozisht bindjet e veta ideologjike. Pra është një politikan që ka një besim ideologjik të konsoliduar mirë.

Zgjim Hyseni : Orientimi ideologjik do të jetë centrist, por në anën tjetër liria e fjalës dhe demokracia tashmë dihet se do jenë të rrezikuara. Qeveria në ardhje mund të vlerësohet mbi presupozimin e realizmit të asaj që ka premtuar, një tekst që vështirë se mund të quhet program. Rishpërndarjen e ka zëvendësuar anti-korrupsioni. Tek ekonomia e kemi një përpjekje për një formë të kapitalizmit shtetëror që i ka limitet tejet të afërta marrë parasysh përmasat e Kosovës, dhe marrëdhëniet ekonomike e tregtare ku jemi të hedhur. Kosova nuk ka mundësi për politika monetare, dhe është pjesë e dy marrëveshjeve tregtare CEFTA dhe MSA. Sigurisht, kjo na kthen tek një pyetje themelore: a janë të mjaftueshme instrumentet që t'i jep shteti për tejkalim të shtrëngësive të neoliberalizmit? A është e mundur të përsëritet e njëjta rrugë zhvillimi e industrializmit sikur para shumë dekadave apo një shekulli? Për vete nuk besoj se mund të presim

transformim të ekonomisë.

Dimensioni ideologjik

– A prisni që pas zgjedhjeve të fundit, skena politike e Kosovës të jetë më e profilizuar ideologjikisht?

Blerim Latifi: Zgjedhjet e 14 shkurtit nuk paraqesin vetëm një rotacion të thjeshtë pushteti. Fitorja e thellë e Lëvizjes Vetëvendosje në këto zgjedhje do të ndikoj që partitë tjera të rimendojnë çdo gjë të tyren, mënyrën e organizimit, mënyrën e të bërit politikë dhe sigurisht vlerat ideologjike mbi të cilat ato do ta mbështesin veprimin e tyre politik. Partitë tjera nuk guxojnë të nisen nga ideja se pushteti do ta korruptojë dhe stërkeq edhe Kurtin e partinë e tij dhe pastaj mbi bazën e kësaj ato të projektojnë rikthimin e tyre në pushtet. Kurti do të qëndroj fort i lidhur me agjendën e tij të antikorrupsionit dhe e vetmja fushë në të cilën partitë tjera do të mund të bëhen gati për ta goditur do të jetë ajo e politikave të tij qeverisëse, në radhë të parë, politikës ekonomike. Kjo natyrshëm do të ndikoj që debati politik në Kosovë të marrë edhe dimensione ideologjike.

“Fitorja e thellë e Lëvizjes Vetëvendosje në këto zgjedhje do të ndikoj që partitë tjera të rimendojnë çdo gjë të tyren, mënyrën e organizimit, mënyrën e të bërit politikë dhe sigurisht vlerat ideologjike mbi të cilat ato do ta mbështesin veprimin e tyre politik” – Blerim Latifi

Zgjim Hyseni : Nuk shoh ndonjë zhvillim që mund ta vlerësoja si rrugë e shtruar për diçka të tillë. Përveç kësaj nuk pajtohem me shpjegimet deterministe që lexojnë zhvillimet në mënyrë lineare përmes kauzalitetit të pafundëm shkak-pasojë. Mund të them që në Kosovë ka nevojë për ndërhyrje për të dekonstruktuar dy gjëra: diskursin totalitar që arsyeton gjithçka në emër të garancës historike, pra fundit të premtuar; dhe antikorrupsionin që ysht njerëzit drejt hakmarrjes pa u dhënë atyre mundësitë për çlirim.

– Megjithë paqartësitë e cakuara të tyre ideologjike,

sikur duket që Vetëvendosja dhe LDK e PDK, kanë krijuar monopol dhe hegjemoni, në lidhje me përfaqësimin e së majtës dhe së djathtës kosovare. Si e shpjegoni këtë?

Blerim Latifi: Po, kjo shpjegohet me faktin se janë tri partitë kryesore politike në vend. Hegjemoni ideologjik nuk mund të vendosin partitë e vogla. Partitë e vogla e kanë vetëm një preokupim: Si të mbijetojnë në tregun politik ?

Zgjim Hyseni: Përshtypja ime është që VV është aktualisht hegjemonia e vetme. Por, edhe sikur të pajtohesha me konstatimin tuaj, shpjegimin nuk do ta kisha tjetër. Vendimtare në vendosjen e hegjemonisë nuk është vërtetësia, as saktësia shkencore. Hegjemoninë e vendos efikasiteti i saj, pra raporti i forcave. Ideologjia dominante s'është tjetër gjë veç partikularitet që është totalizuar nga propaganda. Ndarja e vizatuar që shenjues kryesor e ka korrupsionin si shkak dhe pasojë për gjithçka është treguar efikase.

– Partitë kryesore politike në Kosovë deklarohen të qendrës së djathtë, apo të qendrës së majtë. Ç'nënkuptojnë për ju sot e majta dhe e djathta kosovare, për nga aspekti ideologjik dhe socio-historik?

Blerim Latifi: Konsideroj se dallimi midis të majtës dhe të djathtës në politikën kosovare më shumë është një dallim nominal, se një dallim esencial. Partitë politike kosovare deklarohen vazhdimisht se i takojnë këtij apo atij spektri ideologjik, por kur ballafaqohen me situatat konkrete të qeverisjes, ato, pothuajse të gjitha, ndjekin të njëjtat politika publike dhe ekonomike. Kjo gjë, natyrisht, është e kushtëzuar me faktin se Kosova ndodhet në një situatë specifike, e cila nuk e lejon, ta themi kushtimisht, luksin e debatit ideologjik në trajtimin e çështjeve emergjente të shtetit, siç janë ato që lidhen me procesin e shtetndërtimit ose të mirëmbajtjes së stabilitetit makroekonomik të vendit. Sigurisht se kemi politikanë që kanë bindjet e tyre ideologjike, të majta apo të djathta, por këto bindje nuk mund ta ndryshojnë esencialisht agjendën themelore në të cilën është përfshirë Kosova, e që është konsolidimi i shtetit dhe përmbyllja e subjektivitetit të tij ndërkombëtar. Shikuar nga një pikëpamje tjetër, sot, mund të shohim se të dy krahet ideologjike më shumë se përballë njëri tjetrit, qëndrojnë të përzierë me njëri tjetrin. Pra, mund të flasim për parti politike që në programet e tyre përmbajnë elemente, koncepte, vlera e pikëpamje nga të dy polet tradicionale ideologjike. Ky është pak a shumë koncepti

i atyre që njihen si “catch-all party”, një lloj partie politike e cila përpiqet të sigurojë mbështetje nga të gjitha grupet e shtresat e shoqërisë dhe nga të gjitha llojet e bindjeve politike e filozofike që ekzistojnë në shoqëri. Ky model i partive politike mundëson që të djathtët dhe të majtit, ekstremistët dhe të moderuarit, të bashkohen në një strukturë partiake, e cila synon para së gjithash marrjen e pushtetit politik. Sigurisht më e suksesshmja në këtë drejtim ka qenë Lëvizja Vetëvendosje, e cila kishte nisur si një lëvizje politike me profil tejet të qartë ideologjik, të frymëzuar nga e majta ideologjike, dhe tani shfaqet si një parti politike që ka përfshirë brenda saj njerëz nga të gjitha profilet e mundshme ideologjike.

Zgjim Hyseni: Rrethanat jo të zakonshme të historisë së vonë nuk kanë mundësuar profilizim të zakonshëm ideologjik. Kjo, sepse në Kosovë, së paku nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, temë qendrore është “rruga drejt çlirimit”. Dy fjalët e fundit janë edhe demarkime të rrymave që vijnë e bëhen kampe. Njeri krah ishte ai i rezistencës, njerëz e organizime që refuzonin çdo bashkëpunim me Jugosllavinë. Për ta Jugosllavia ishte thjesht një shtet pushtues. Kundër tij duhet punuar me popullin për t'u hedhur në kryengritje. Bëhet fjalë për grupet ilegale marksiste-leniniste që sytë e veshët, por sidomos zemrën e kishin kah Shqipëria. Krahu tjetër është si i klasës politike e kulturore që ishte integruar dhe udhëhiqte institucionet politike dhe ndërmarrjet. Kjo linjë pretendonte se bashkëpunimi dhe integrimi brenda Jugosllavisë do ta siguronte madje edhe vetë republikën. Argumenti kryesor i tyre ishte Kushtetuta e vitit 1974 dhe ngritja e statusit politik të Kosovës si njësi konstitutive. Të parët flasin për periudhën e rëndë të Rankoviqit, dëbimet masive drejt Turqisë, por sidomos faktin se pavarësisht përmirësimeve, krahasimisht me republikat tjera të ish Jugosllavisë, pabarazia ishte rritur. Shikuar historikisht, ideologjia tek ne, përbën identifikime që ne i kemi si marrëdhënie me historinë. Këtu kemi data historike dhe rryma politike: ata që lartësojnë demonstratat e vitit 1981 si shpërfytyrim i ngrehinës së dhunshme jugosllave; përkundër atyre që i denuan ato si ndalim i progresit që po çonte drejt republikës. Për ta përmbledhur, deri në vitin 1999 kemi më shumë pozicione e qëndrime mbi përkufizimet e pushtuesit, pushtetit, apo aspirates për çlirim, sesa programe e perspektivë mbi shoqërinë dhe qeverisjen. Përfundimi i luftës në Kosovë këto dy kampe i gjen të armiqësuar. Faktorët ndërkombëtar kanë

nxitur politika që ndajnë pushtetin e ushqejnë kompromiset midis partive. Si rezultati i kësaj, por edhe i një përhumbeje ideologjike që vjen prej dominimit global të neoliberalizmit, për një kohë të gjatë Kosova ka pasur politika të konsensusit. Përrjashtoj disa ndryshime të vogla, ne e kemi të njëjtin sistem tatimor prej kohës së administrimit ndërkombëtar; politikat e privatizimit kanë vazhduar, pavarësisht ndryshimit të qeverive.

– Z.Latifi, cilat janë vlerat e djathta, sipas jush të domosdoshme, që duhen të mirëmbahen e kultivohen në shoqërinë kosovare?

Blerim Latifi: Sigurisht që kemi nevojë të domosdoshme për ruajtjen dhe afirmimin e vlerave të së djathtës, kam parasysh vlerat e qendrës së djathtë, siç janë identiteti kombëtar, vlerat historike e tradicionale të këtij identiteti, përfshirë këtu identitetin evropian të popullit tonë, nacionalizmin demokratik, liberal dhe sekularist, si dhe ndërtimin e një kapitalizmi me tipare të kapitalizmit perëndimor, që funksionon në korniza të sundimit të ligjit.

“Çfarë duhet ndërruar si logjikë është paradigma dominuese e anti-korrupsionit. Gjendja e rëndë ekonomike duhet shpjeguar përmes pabarazisë dhe shfrytëzimit, dhe jo përmes moralit anti-korrupsion” – Zgjim Hyseni

– Z.Hyseni, ku mendoni se do të duhej të bazohet një program i majtë për realitetin kosovar?

Zgjim Hyseni: E majta në Kosovë duhet ta zgjerojë territorin dhe ta ndërrojë logjikën. Territorin sepse duhet artikuluar çështje e kontradikta që kanë ndikim të madh. Pak flitet për to. Ta zëmë, emigrimi masiv i qytetarëve të Kosovës drejt vendeve të BE-së ka mbetur pa u artikuluar. Në Kosovë, shumica e njerëzve mendon se kjo ikje vjen si rezultat direkt i korrupsionit. Jo për ta mohuar ekzistencën e korrupsionit, por struktura e ekonomisë në Kosovë në masë të madhe përcaktohet prej marrëdhënieve tregtare ndaj të cilave jemi të ekspozuar. Kjo vlen për Kosovën, por edhe për vendet e tjera të Ballkanit. Nuk mund të flasim për të majtën brenda vendeve të vogla pa u sqaruar karshi fenomenit që do ta quaja “zhvillim i pabarabartë” midis vendeve të Ballkanit dhe Bashkimit Evropian. Çfarë duhet ndërruar si logjikë është paradigma dominuese e antikorrupsionit. Gjendja e rëndë ekonomike duhet shpjeguar përmes pabarazisë dhe shfrytëzimit, dhe jo përmes moralit antikorrupsion. Qeveria e re mund të bëjë rides-tinime të mjeteve nga njëra fushë në tjetrën, por ata tashmë kanë treguar se tatimi i sheshtë do të vazhdojë. Kosova nuk do ta ketë as me qeverinë e majtë një taksë mbi dividendin. E majta po ashtu duhet ta ndërlihdë përpjekjen për barazi shoqërore me luftën



ZGJIM HYSENI

kundër patriarkalizmit, të drejtat e minoriteve etnike, por edhe komunitetin LGBTQ që bën jetë gjysmë ilegale.

Pengu nacionalist

– **Asnjë organizatë politike në Kosovë nuk proklamohet si e djathtë dhe e majtë ekstreme. Pse? A do të thotë kjo se nuk ekzistojnë?**

Blerim Latifi: Në studimet klasike të politikës moderne, zakonisht, me të majtë ekstreme kuptohen partitë e tipit leninist, të cilat mbështeten në metodën e marrjes me forcë të pushtetit dhe kanë për synim ndryshimin radikal të shoqërisë, ndërsa me të djathtë ekstreme kuptohen partitë e tipit fashist, të cilat dhunën politike e justifikojnë përmes idealeve të mëdha mbi kombin, apo racën. Pra, ekstremizmi politik kuptohet përmes ligjërimit të dhunës politike si mjet normal i veprimit politik. Natyrisht, ka shumë autorë që e kontestojnë këtë lloj ndarje, duke shtruar teza të tjera, të cilat thonë se komunizmi dhe fashizmi nuk janë kundërshtarë ideologjikë të njëri tjetrit, as antipode të njëri tjetrit, por dy ideologji ekstremiste që kanë lidhje gjenetike me njëra tjetrën. P.sh. njëri nga filozofët më të njohur gjermanë të ditëve të sotme, Peter Sloterdijk konsideron se fashizmi është socializëm kombëtar, një lloj imitim i komunizmit, por pa qëllimet e tij internacionaliste. Njësoj si komunizmi, edhe fashizmi është një ideologji që fokusohet në kolektivizmit e frontit, në egalitarizmin e prodhimit, por që dallon në faktin se fashizmi është një komunizëm pa proletariatin, apo një komunizëm me bazë folklorike. Tani, për t'u kthyer në rastin e Kosovës duhet të theksojmë se politika kosovare ka qenë larg projeksioneve të tilla ideologjike. Nacionalizmi shqiptar kurrë nuk ka pasur tipare fashiste, ndërsa komunizmin e kemi përjetuar gjithmonë si një ideologji të imponuar nga regjimi jugosllav. Kur flasim për periudhën e pasluftës ne mund të konstatojmë aty këtu ndonjë element të lidhura me këto ideologji ekstremiste, por

asnjëherë nuk kemi pasur grupacione që janë ngritur mbi bazën e inspirimit nga e majta apo e djathta ekstreme, përjashtoj rastin e viteve të para të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila hapur promovonte një diskurs ideologjik të frymëzuar nga leninizmi revolucionar. Ka pasur shumë individë brenda Lëvizjes Vetëvendosje që kanë flirtuar me idetë e të majtës ekstreme, por tani duket qartë se pozicioni aktual i Lëvizjes Vetëvendosje më shumë ka të bëjë me idetë dhe politikën e qendrës së majtë, me atë që njihet si socialdemokraci.

Zgjim Hyseni: Askush nuk e quan veten “ekstremist”. Ky emërtim vjen gjithmonë nga jashtë. Topologjia politike që vizaton forma, kufij dhe pozicione, që dikë e vendos në qendër e dikë tjetër në skaj, është gjithnjë pozicion subjektiv i normalizuar përmes aparateve ideologjike. Gjithsesi, ky denominim ngjanë si etiketë që vjen prej pushtetit të konsoliduar në qendër. Ka autorë që këtij zakoni i përgjigjen me “qendrën ekstreme”, pozicion ky që përmes dominimit neoliberal ka sheshuar çdo kontradiktë e çdo dallim, duke e shndërruar politikën kështu në çështje të menaxhimit e efikasitetit. Për vete, më parë sesa “ekstrem”, do të përdorja shpjegime e koncepte që sinjalizojnë rrezikun ndaj demokracisë. Kështu, duhet reaguar për format e ndryshme të fashizmit, apo të totalitarizmit që vjen prej traditës së bolshevizmit. Gjithsesi, fjala ime e përmbledhur për këtë temë do të ishte: nuk na duhet konsensusi, por demokracia. Demokracia si shenjues i zbrazët, si vend i kontradiktave, si heterodoksi, pa garancë dhe ontologji të subjektivit.

– **Nacionalizmi është një nga pikat e përbashkëta të partive kryesore politike kosovare, pavarësisht orientimit të tyre ideologjik. Si e shpjegoni?**

Blerim Latifi: Ne nuk duhet ta harrojmë faktin se historia e shekullit të kaluar dhe kjo e dy dekadave të shekullit XXI, në thelbin e saj, është rezultat i konfliktit midis nacionalizmit shqiptar dhe nacionalizmit serb.

Për të mos shkuar shumë larg, së paku nga viti 1981 çështja kryesore politike në Kosovë ka qenë çështja kombëtare, pra realizimi i të drejtave kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Kjo çështje do të mbetet në rend të ditës deri në momentin kur do të përmbyllet procesi i brendshëm dhe i jashtëm i shtetndërtimit të Kosovës, prandaj, deshën apo nuk deshën, partitë politike shqiptare në Kosovë janë të detyruara ta kenë nacionalizmin si një komponentë të pashmangshme në profilin e tyre ideologjik. Kur t'i mbyllim çështjet me Serbinë, nacionalizmi do të riorientohet në çështjen e raporteve të Kosovës me Shqipërinë, çështje e cila në krye të herës ka të bëjë me bashkimin ose jo të këtyre dy shteteve.

– **“Kur t'i mbyllim çështjet me Serbinë, nacionalizmi do të riorientohet në çështjen e raporteve të Kosovës me Shqipërinë, çështje e cila në krye të herës ka të bëjë me bashkimin ose jo të këtyre dy shteteve” – Blerim Latifi**

Zgjim Hyseni: Kjo gjë shpjegohet me marrëdhëniet ende të tendosura midis shteteve e popujve të Ballkanit. Për këtë gjë nuk do të vendosja barazim duke i quajtur të gjithë njëjtë: “nacionalistë”. Kjo sepse duhet ruajtur dallimin midis ekspansionit dhe luftës për liri. Kjo sa i përket dimensionit historik. Në anën tjetër, të gjitha forcat politike këtu kanë përgjegjësi sepse nuk ia kanë kushtuar rëndësinë e duhur zgjidhjes përfundimtare të problemit Kosovë-Serbi. Klasa politike këtu ka abstenuar dhe i ka ikur dialogut për arsye kryesisht populiste dhe llogari të ngushta politike.

– **Partitë në Kosovë, në veçanti VV dhe LDK, kanë tashmë aleanca me parti të ndryshme simotra nëpër Evropë, por jo edhe aq në Ballkan. Ç'flet kjo për juve?**


Blerim Latifi: Sepse në Ballkan ende është nacionalizmi ai i cili u jep formë marrëdhënieve politike dhe ideologjike midis shteteve dhe partive të tyre politike. Dhe kështu do të jetë derisa nuk mbyllen të gjitha çështjet nacionale midis shteteve të këtij rajoni, qoftë përmes integritetit të tyre në Bashkimin Europian, qoftë përmes marrëveshjeve historike midis palëve që janë të përfshira në konteste të ndryshme nacionale.

Zgjim Hyseni: Duhet thënë së pari së një gjë e tillë nuk është e mirë. Qytetarët nga vende të ndryshme të Ballkanit kanë shumë probleme të përafërta, por moszgjidhja e problemeve politike minon çdo formë bashkëpunimi.

EDITORIAL

“Heshtni !”

NGA SERGE HALIMI



Më 9 janar 2021, njëmbëdhjetë ditë para përfundimit të mandatit të z.Donald Trump, përdërisa e patën braktisur edhe disa republikanë, Twitter vendosi ta mbyllë llogarinë e tij dhe Facebook ta pezullojë atë. Të këqijat e ish-presidentit nuk ishin megjithatë më vdekjeprurëse, se ato të Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA) ose krerëve të tjerë të shteteve, llogaritë e të cilëve nuk janë kërcënuar kurrë. Të pretendosh (gabimisht) se humbja e tij zgjedhore ishte siguruar përmes mashtrimit nuk ishte më keq se ta kërcënosh (në Twitter) Korenë e Veriut me sulm bërthamor.

“Gjuha e urrejtjes” e z.Trump të cilën e ndalojnë sot platformat elektronike pasi që përfutuan jashtëzakonisht shumë prej saj, nuk është e barabartë me ashpërsinë ekstreme që të njëjtat rrjete “sociale” kanë shpërndarë në Mianmar ose në Indi kundër pakicave myslimane.

Por, Twitter dhe Facebook nuk karakterizohen nga koherenca ose guximi i tyre. Të inkurajuar nga lehtësia e pabesueshme e qeverive dhe individëve që i lejuan atyre të vepronin dhe të rriteshin, Twitter dhe Facebook arritën në përfundimin se gjithçka i lejohej. Derisa të mund t'ia mbyllin gojën Presidentit të Shteteve të Bashkuara, që është një masë marramendëse e fuqisë që kanë fituar.

Por, kur indinohet e djathta amerikane, tundohej t'i përgjigjemi: a nuk jeni ju dhe mendimtarët tuaj të Çikagos që ndërtuat idenë që pushteti publik nuk duhet ta përmbajë as fuqinë e kompanive dhe as pasurinë e pronarëve të tyre, të legjitimuar sipas jush nga zgjedhja e lirë e konsumatorëve?

Epo, ju po bëheni viktimat e sotme të “popullizmit të tregut”. Amendamenti i parë i Kushtetutës së SHBA mbrosh shprehjen e lirë nga censura e shtetit federal dhe qeveritë lokale, por jo kundër korporatave private në gjendje monopoli. “Shprehja” e tyre është heshtja juaj. Vae victis dhe tërë pushteti GAFA[1] kur ua mbyllin gojën!

Megjithatë, ky është rreziku tjetër i njerëzve të rrezikshëm dhe ideve që mbartin. Pranojmë gjithçka për t'u mbrojtur, përfshirë edhe pezullimin e pacaktuar të lirive themelore. Por, kur bëhet fjalë për t'i luftuar idetë terroriste, raciste, antisemite, “separatiste”, lufta nuk është kurrë e fituar, aq më pak me një dorëzim zyrtar të të mposhturëve. Do ta përjetojë vetëm një gjendje përjashtimi që zgjat dhe forcohet.

Asgjë nuk mund të jetë më e lehtë, në të vërtetë, sesa ta identifikosh një shënjestër të urreyer që askush nuk do të dëshirojë të duket se do ta shoqërojë, dhe pastaj ta zgjerohet vazhdimisht perimetrin e anatemave dhe ndalesave. Kundërshtarët e luftërave në Afganistan dhe në Irak ishin quajtur avokatë të Al-Kaidës; kritikët e politikave të Izraelit si antisemit. Në rast të tilla, njeriu nuk kërkon t'i kundërshtojë rivalët e tij, por t'i heshtë ata.

Dhe në këtë mënyrë, në një heshtje shqetësuese, vrasja e Samuel Paty shërbeu si pretekst për shpërbërjen e Kolektivit kundër Islamofobisë në Francë. Sikurse që çdo ditë e më shumë, larg zgjerimit të perimetrit të lirive, shpërthimi i rrjeteve të komunikimeve ndërton shoqëri disiplinuese të cilat na dënojnë për të udhëtuar midis vendeve tona të izolimit.

[1] Google, Apple, Facebook, Amazon.

KUR BALLKANIZIMI FAVORIZON KLANIZMIN

Klientelizmi dhe identitetet e trazuara në Malin e Zi

Për herë të parë në historinë e tij, Mali i Zi po përjeton ndryshim pushteti përmes kutive të votimit. Nën drejtimin e z.Milo Gjukanoviq, ekipi në ikje ka qenë në mënyrë të njëpasnjëshme komunist, nacionalist panserb, rusofil; separatist, e pastaj atlantist dhe pro-evropian...Mazhoranca e re nuk i ikën dot logjikave të identitetit ose presioneve të jashtme që imponojnë një kornizë të ngushtë për rinovimin e pritshëm.

NGA TË DËRGUARIT TANË SPECIALË PHILIPPE
DESCAMPS DHE ANA OTAŠEVIC*



Për ta përballuar të ftohtin thumbues në fund të tetorit në një lartësi prej më shumë se 1700 metrash, militantët u mbledhën rreth një zjarri të madh. Ndodhemi në pllajën Sinjajevina, një Larzac i ri në malet e Malit të Zi verior. Ashtu si në pllajën franceze në mesin e viteve 1970, popullsia lokale, e mbledhur nga ambientalistët, kanë frikë se këto kullota të shkëlqyera do të shndërrohen në tokë ushtarake.

“Qeveria në ikje dëshironte që kjo zonë e liqenit Savina Voda të shërbente si fushë për manovrim dhe shkatërrim të municioneve të vjetëruara”, shpjegon Milan Sekuloviq, themelues i iniciativës së qytetarëve Sauvons Sinjajevina në 2018. Fermat e rreth pesëdhjetë familjeve u kërcënuan, kur numri i fshatarëve vazhdoi të ulet për mungesë të ndihmës publike, investime në rrugë ose në energji elektrike. «Vendi ynë importon 80% të ushqimit të tij, ndërkohë që mund të zhvillojmë blegtori dhe vetëfurnizim».

Pas goditjes së 30 gushtit 2020 dhe humbjes elektorale të një ekipi të vendosur që nga Jugosllavia komuniste, aktivistët po presin për angazhime të vendosura nga një qeveri e re nën presionin e jashtëm. Që nga viti 2017, ushtria malazeze është anëtare e trupave të Organizatës

së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), sekretari i përgjithshëm i të cilit ka marrë një pozicion të paqartë. Më 21 tetor, z.Jens Stoltenberg iu përgjigj një gazetari: “Unë kam besim se ka mënyra për të pajtuar nevojën dhe për të mbrojtur natyrën dhe në të njëjtën kohë, për të trajnuar forcat e armatosura, gjë e cila është e rëndësishme për të gjithë aleatët”.

Në një vend i cili u bombardua nga aeroplanët e NATO më 1999, ndërsa ishte ende i bashkuar me Serbinë, gjatë luftës në Kosovë, tema mbetet më e ndjeshme. Mobilizon, përtej ambientalistëve dhe fshatarëve, ata që e quajnë veten kryesisht serbë, në krahasim me një pushtet të konfiskuar prej atyre që pretendojnë të jenë ekskluzivisht malazezë. Këto dy identitete janë të përafërta, madje sipas disave, të ngatërrueshëm me njëri tjetrin. Një automjet i zi i afrohet tubimit. Del nga automjeti një gjigant Peshkopi i Eparkisë së Budimlje-Nikshiq, numri dy në Kishën Ortodokse Serbe të vendit, z.Joanikije Miçoviq ecën fuqishëm drejt njerëzve, me shkop të zbuluar në dorë dhe mjekër të bardhë. Para se të fillojë fjalimin, ai dëshiron të pagëzojë vullnetarët në brigjet e liqenit të vogël.

“Ky është një moment i rëndësishëm”, thotë ai. “Lufta e fundit

kundër komunizmit dhe ajo që shkaktoi në Mal të Zi pas vitit 1945. Tani njerëzit po kthehen në besimin e tyre. Këta njerëz mbrojnë tokën, burimet e tyre natyrore, gjithçka që përbën jetën dhe mbijetesën e tyre. Ata gjithashtu mbrojnë trashëgiminë, historinë e tyre familjare”. Për të, kjo luftë ekologjike i bën jehonë një tjetër, e cila sapo ka përmbytur gjithçka: ajo e kryer për një vit kundër ligjit “për lirinë fetare”, e perceptuar si një mjet për shkatërrimin e Kishës Ortodokse Serbe, të manastireve të saj dhe vendet e lutjes. “Ata donin të na merrnin pronën, por edhe identitetin tonë. Nuk kishim zgjidhje tjetër përveç protestës”, tha peshkopi, i cili kaloi tre ditë në paraburgim në polici në maj të vitit 2020. “Kjo krijoi një bashkim midis njerëzve. Kishte njëqind mijë njerëz në rrugë, ekuivalenti i dhjetë milion demonstruesve në Francë”.

Si trashëgimtare e drejtpërdrejtë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, kameleon politik mahnitës, Partia Socialiste Demokratike (Demokratska Partija Socijalista, DPS) e z.Milo Gjukanoviq mbeti në pushtet për tridhjetë vjet, megjithë ndryshimet e saj të njëpasnjëshme: partizane e më vonë kundërshtarë e liderit serb Slobodan Milosheviq, kundërshtarë e më vonë mbështetëse e pavarësisë, rusofile

pastaj atlantiste. Rastet e panumërta që prekën udhëheqësit e saj ose ekodi që preku rininë nuk çuan as në largimin e pushtetit nga duart e saj. Nga ana tjetër, DPS sapo ka rënë në një pikëpyetje identiteti, pasi deshi ta ndërtonte një Kishë Ortodokse Malazeze autoqefale në kurriz të Kishës Serbe, për të cilën shumica e popullsisë mbetet e lidhur: në regjistrimin e fundit, në 2011, 72% e banorëve e deklaruan veten ortodoksë, 19% myslimanë dhe 3% katolikë. Etnikisht, ortodoksët u vetëdeklaruan ose malazezë (45% e popullsisë) ose serbë (28,7%); 8.6% thanë se ishin boshnjakë dhe 4.9% shqiptarë (pa llogaritur abstenimet dhe rreth 15 opsione të tjera). Por shumë prej atyre që e deklarojnë veten malazezë ndjekin Kishën Serbe. Gjatë epokës komuniste ishte më mirë të quheshe malazez, të cilën e kishin bërë 90% e të anketuarve në regjistrimin e vitit 1948 dhe një tjetër 68% në atë të vitit 1981 (3.3% në atë kohë thanë se ishin serbë).

Një marinë për të huajt e pasur

Shfaqja e një identiteti kombëtar malazez të dallueshëm nga identiteti serb nuk është vetëm për shkak të faktorëve historikë ose gjeografikë, shpjegon specialisti gjeopolitik

Amaël Cattaruzza: “Politika autoritare e Millosheviqit në Serbi dhe strategjia e bashkësisë ndërkombëtare (kryesisht Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian), të cilët u përpoqën ta izoloni regjimin serb, kontribuan në rritjen e radhëve të protestës sovraniste në Malin e Zi. Kjo e fundit arsyeton pretendimet e saj duke shfaqur një ide të caktuar për identitetin kombëtar malazez, herë bazuar në kritere etnike, herë në kritere civile”. Por pasi Milosheviq u largua në 2000, procesi i copëzimit çoi në pavarësinë e Malit të Zi, i zgjedhur në 2006 nga 55% e votuesve, duke lënë jashtë kryesisht ata që e shihnin veten si serbë.

Çështja e identitetit fsheh një çështje sociale. Mbi të gjitha, Mali i Zi është thyer nga një zhvillim shumë i pabarabartë. Me një zonë ekuivalente me rajonin e Île-de-France për 620.000 banorë, ajo ka 66 milionerë, ndërsa një e katërta e popullsisë jeton në kufirin e varfërisë (më pak se 2,261 euro në vit në 2019 për person). Akoma më vendimtare janë pabarazitë rajonale, siç dëshmohet nga shkalla e papunësisë (në 2018, para krizës shëndetësore): 36.6% këtu, në rajonin verior që votuan për ndryshim; 3.9% në rajonin bregdetar.

Në brigjet e Adriatikut, 80 kilometra më në jug, marina e re e Porto Montenegros i përket një bote tjetër. Ish-kantieri i madh i anijeve Tivat, i cili ishte krenaria e flotës detare jugosllave, është shndërruar në një geto për të huajt e pasur: jahte me 165.000 euro javën, hotele prestigjioze, butiqe luksoze. Në Kotor, një gji unik me limanët e tij të egër, fshatrat e peshkimit dhe disa qytete mesjetare të klasifikuar si Trashëgimi Botërore nga Organizata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kombeve të Bashkuara (Unesco), kanë ndryshuar imazhin në dy dekada. Të tërhequr nga lehtësimet në taksa, investitorët e huaj kanë çimentuar vijën bregdetare pa marrë parasysh thesaret e saj natyrore dhe historike ose ligjet e urbanizmit.

Në prag të pavarësisë, kanadezi i pasur Peter Munk, themeluesi i Barrick Gold, prodhuesi më i madh i arit në botë, fluturoi mbi gji me një helikopter ushtarak të dërguar nga z.Gjukanoviq, atëherë kryeministër. Ai vështroi vendin e kantierit detar i cili ende punësonte gati pesëqind punëtorë. Të dy burrat nënshkruajnë një marrëveshje privatizimi: për 23 milion euro, shteti i ri jepte 30 hektarë. Pronar i fonderisë së aluminit në Podgoricë që nga viti 2005 – industria e vetme e madhe në vend – oligarku rus Oleg Deripaska mori pjesë në investime në atë që do të bëhej një Monako e re, së bashku me bankierin britanik Jacob Rothschild dhe oligarkun francez Bernard Arnault.

Në vendet e shkretuara nga ushtria jugosllave, qeveria malazeze favorizoi turizmin luksoz dhe investimet e huaja. Shihet gjithashtu që në Kumbor, në anën tjetër të gjirit, dy vajzat e presidentit të Azerbajxhanit Ilham Aliyev, Arzu dhe Leyla Aliyeva dhe vjehri i saj Arif Pashayev ndërtuan një vendpushim luksoz. Ose në Gjirin Lushtica, ku ndërtoi rezidenca egjiptiani Orascom Development i kontrolluar nga miliarderi Samih Sawiris. “Pas të gjitha këtyre projekteve, si prapa projektit të autostradës, gjendet kompania Bemax, një nënkontraktor malazez i lidhur ngushtë me partinë në largim. Kjo perandori ka gëlltitur të gjitha kompanitë e tjera të ndërtimit në vend”, shpjegon znj.Vanja Çallovic, drejtoreshë e Rrjetit për Afirmimin e Organizatave JoQeveritare (MANS), e cila lufton kundër korrupsionit dhe e cila ka bërë shumë zbulime që kanë mbetur ende pa epilog.

Projekte të tjera për hotelet, kazinotë dhe parqet janë të lidhura me rrjetet kriminale. Krijimi më i famshëm ndodhet pak më në jug të Budvës, në Bençiq. Hoteli Splendid organizoi dasmat e bukura të vajzës, pastaj djalit të “kumbarit” të vendit, z.Branislav Miçunoviq, në prani të shefit të lartë të vendit. Si shumë të tjerë, kjo ndërtesë u ndërtua “pa leje”, na siguron drejtoresha e MANS.

Bomba e vendosur para redaksisë

“Ata që janë në krye marrin pjesën më të madhe të korrupsionit”, thotë Milka Tadiq Mijoviq, gazetare, bashkëthemeluese e të përjavshmes së pavarur ‘Monitor’. « Për tridhjetë vjet, shumica e ndërmarrjeve publike janë privatizuar fshehurazi. Gjulkanoviqi dhe familja e tij janë bërë njerëzit më të pasur në vend. Vëllai i tij Aleksandar, i cili ishte i papunë,

kontrollon kapitalin e institucionit më të madh financiar të Malit të Zi : Prva Banka. Motra e tij Ana, e cila ishte gjykatëse gjatë privatizimeve, zotëron një nga firmat më të mëdha ligjore. Ndonjë investitor i huaj që nuk dëshiron të ketë probleme do të ketë interes të kalojë nëpër shërbimet e kësaj firme“.

Bomba të vendosura para redaksive, goditje me armë zjarri, fushata shpifëse të gazetave të afërta me DPS: zbulimet nga ‘Monitor’ ose të përditshmet e opozitës ‘Dan’ dhe ‘Vijesti’ u kanë krijuar shumë probleme gazetarëve kritikues të pushtetit. “Që nga pavarësia, ka pasur më shumë se tridhjetë sulme fizike ndaj gazetarëve tanë”, thotë Mijoviq. « E përditshmja Pobjeda shkruajti mbi dyqind artikuj për ne. Më quanin “prostitutë” dhe “tradhtarë e atdheut”. M’u deshën shtatë vjet për të fituar një proces gjyqësor. Shumica e këtyre sulmeve nuk janë ndëshkuar kurrë, gjë që nënkupton se dora e pushtetit nuk është shumë larg”.

Ndryshimi i mazhorancës në Parlament nuk do të thotë largim i z.Gjukanoviq, i zgjedhur në presidencë në maj 2018 për pesë vjet. Në fazën e bashkëjetesës që po hapet, ai mban një rol dytësor, por jo të papërfillshëm. Kur e pyesim për shkallën e korrupsionit në vend, përgjigja e tij duket e përgatitur: “Ne jemi një komunitet i vogël dhe gjithçka është ekzagjeruar. Për më tepër, rrethanat janë të tilla që pushteti nuk ka ndryshuar këtu për tridhjetë vjet. Ata që aspirojnë ta zëvendësojnë qeverinë janë përpjekur ta diskreditojnë atë me të gjitha mjetet, duke përfshirë edhe fryrjen e rëndësisë së kësaj çështje. Nuk ka dyshim se ky problem ekziston; është gjithashtu e padiskutueshme që shteti po e merr atë seriozisht ». Ai reagon më fuqishëm kur përmendim disa raste që kanë mbetur pa përgjigje, të cilat mund të sugjerojnë një klimë pandëshkueshmërie: “Ky është një perceptim krejtësisht i rremë. Njerëzit shumë afër meje janë ndjekur penalisht dhe janë dënuar”.

Presidenti i referohet fatit të ish-krahut të tij të djathtë, z.Svetozar Maroviq, President i Shtetit të Serbisë dhe Malit të Zi nga 2003 deri në 2006 dhe numri dy në DPS. Me nofkën “Pashai i Budvës”, ai u arrestua për korrupsion dhe krim të organizuar më 2015, pastaj u dënua me dyzet e katër muaj burg, para se të arratisëj në Serbi. I paraqitur si provë e luftës kundër krimit të organizuar, rënia e “klanit Maroviq” është interpretuar nga opozita si një zgjidhje hesapshë brenda pushtetit. “Gjëja më e rëndësishme tani do të ishte të kishim një gjyqësor të pavarur”, tha Mijoviq. Dhe unë jam i sigurt se nëse mund ta bëjmë këtë do të shohim shumë raste që dalin në lidhje me Gjulkanoviq dhe familjen e tij”.

Për ta kuptuar ndjenjën e mosndëshkimit që pllakosi fushatën zgjedhore, ne hipim në një varkë në Liqenin e Shkodrës me z.Drazhen Ivanoviq, ish-kreu i gjashtëmbëdhjetë rojeve të parkut kombëtar që mbulon gjithë zonën e liqenit. Një perlë rajonale e biodiversitetit, me reputacion, si shtëpia e pelikanëve të rrallë të Evropës dhe qindra specieve të shpendëve, ky liqen i përbashkët me Shqipërinë dikur ishte i mbushur me krap, ngjala dhe peshq të tjerë delikatë. Për nëntë vjet, z.Ivanoviq gjurmoi gjuetarët pa leje që përdorin elektro-peshkim dhe metoda të tjera të ndaluara. Ai gjithashtu na

tregon gjurmët e ndërtimeve pa leje që ishte në gjendje të bllokonte. I neveritur nga mungesa e burimeve dhe dobësia e sanksioneve përballë kërcënimeve që i kanoseshin shumë specieve, ai dha dorëheqje në fund të verës: “Për peshkatarët që abuzojnë, gjobat nuk do të thonë shumë; ata mund të paguajnë kur kapen. Plus, ne kemi vetëm pesë varka, shumë të ngadalta. Ligjet janë tragjikisht të modifikuara”.

Ekocidi dhe korrupsioni shkojnë dorë për dorë

Një tjetër mrekulli e vendit, lumi Tara është vendosur nën mbrojtje të trefishtë: park kombëtar, klasifikim në Unesco dhe deklaratë e parlamentit. Kjo nuk parandaloi dëmet e riparueshme, të kryera gjatë ndërtimit të autostradës që do të lidhë portin e Bar-it në Boljare (Serbi) dhe Beogradin. Nga Adriatiku në kufirin serb janë planifikuar 170 kilometra autostradë, me shumë struktura: rreth 40 tunele, dy herë më shumë ura. Tashmë, grumbujt e një ure për të kapërcyer relievin ngrihen 200 metra mbi kanionin e Moraçës. Një flamur i madh malazez mbulon njërën prej tyre, për të festuar përfundimin e kësaj etape.

Ky projekt nuk do ta kishte parë kurrë dritën e dritës pa investitorë të huaj. Banka kineze Exim ka dhënë hua 809 milion euro për shtrirjen e parë prej 41 kilometrash, të ndërtaur nga China Road and Bridge Corporation. I gjithë projekti duhet të ketë kushtuar 2.5 miliardë euro, ose ekuivalenti i gjysmës së pasurisë kombëtare të prodhuar çdo vit... Për z.Aleksandar Peroviq, kreu i organizatës mjedisore Ozon, ekocidi dhe korrupsioni shkojnë krah për krah. Ai po bën fushatë për qeverinë e re që të miratojë planifikimin ekologjik: “Kemi frikë se shoqëria po hyn në një periudhë revanshizmi dhe iniciativa jonë synon ta kapërcejë retorikën e rreme rreth dashurisë për atdheun. Një mbrojtje e vërtetë e atdheut duhet të fillojë me mbrojtjen e mjedisit të tij, të burimeve të brishta natyrore”.

Tani jemi në manastirin Cetinje, bastion i rezistencës shekullore kundër osmanëve dhe zemrës historike të vendit. Më 31 tetor, besimtarët janë grumbulluar jashtë për t’i bërë nderimet e tyre të fundit Amfilohije Radoviq, peshkopit të Kishës Ortodokse Serbe dhe figurë e protestës kundër regjimit në ikje. Brenda, disa udhëheqës të mazhorancës së re, duke përfshirë kryeministrin Zdravko Krivokapiq, qëndrojnë pranë arkivolit të hapur. Kryepeshkopi ortodoks u përfshi nga vala e dytë e Covid-19, e cila po prek brutalisht Ballkanin. Ai ka qenë një burrë me mjekër të gjatë dhe me sy të errët dhe ka udhëtuar në vend në mënyrë të përsëritur për ta rindërtuar Kishën që nga emërimi i tij në 1990.

Evangelizator, ai ishte gjithashtu një njohës i politikës, duke mbështetur z.Gjukanoviq kur u largua nga mentori i tij Milosheviq më 1997. Edhe pse i heshtur gjatë fushatës për pavarësi në 2006, ai u bë gjithnjë e më kritik ndaj pushtetit dhe shpërndarjes së parave që mblidheshin për bamirësi, maskuar nga ndërtimi i një nacionalizmi malazez të konsideruar fiktiv, përmes gjuhës ose fesë. Amfilohije kritikoi gjithashtu presidentin serb Aleksandar Vuçiq dhe marrëdhëniet e tij me Kosovën.

Të nesërmen, më 1 nëntor, gjejmë të njëjtin entuziazëm në turmën e pamasë që pushton sheshin e katedrales së Podgoricës. Pa distancim fizik dhe masa të tjera, mijëra njerëz erdhën për të marrë pjesë në varrim dhe spontanisht u gjuhëzuan kur mbërriti kortezhi i varrimit. “Ne kemi humbur kryepeshkopin, pajtuesin e popullit”, tha Svetozar Paviçeviq, 95 vjet, i cili erdhi në këmbë nga fshati i tij. Ndërsa presidenti i Malit të Zi duket si i munguari i madh, një president tjetër shfaqet në radhët e para, së bashku me personalitete fetare nga e gjithë bota ortodokse. Kjo është hera e parë që Vuçiq viziton Malin e Zi që nga marrja e detyrës së udhëheqësit serb më 2014 (së pari si kryeministër, pastaj si president më 2017). Kjo ftohtësi e dukshme e marrëdhënieve me z. Gjulkanoviq fsheh disa të përbashkëta: pushtet i padiskutueshëm, e njëjta shije për projekte të mbivlerësuara të financuara nga investitorë të huaj dhe e njëjta mënyrë e drejtimit të vendit si një çështje familjare, me pushtet mbi institucione dhe media.

Një mazhorancë e re heteroklite

Në një intervistë me stacionin televiziv opozitar ‘Vijesti’, z.Vuçiq mbron lidhjet e fshehta që i atribuohen atij me presidentin malazez, ashtu edhe akuzat për ndërhyrje në zgjedhjet e vendit: “Unë nuk jam ambasadorja amerikane për të treguar se kush mund të hyjë në qeveri dhe kush nuk mundet”, thotë ai, për të treguar se nëse mund të ushtrohen presione të jashtme në Podgoricë, ato nuk vijnë nga Beogradi. Disa ditë më parë, ambasadorja e SHBA-së Judy Rising Reinke me të vërtetë i bëri thirrje publikisht Krivokapiq “për t’u siguruar që të emëruarit në qeverinë e re, veçanërisht në pozicione të ndjeshme në siguri, të kenë një lidhje të provuar me vlerat perëndimore, me sovranitetin e Malit të Zi dhe me linjën euroatlantike, e cila përfshin përgjegjësitë ndaj NATO-së”.

Për kryeministrin e ri i cili më parë kishte qenë profesor i inxhinierisë mekanike në Universitetin e Podgoricës, formimi i një qeverie nuk ka qenë i lehtë. I zgjedhur nga kleri, ai udhëheq një ekip heteroklit që bashkon liberalët atlantistë dhe konservatorët e afërt me Serbisë, por edhe ambientalistë dhe ish-socialistë. Ai jo vetëm që nuk mund të mbështetet në një parti politike besnike, por gjithashtu duhet të përballet me skepticizmin e kancelarive perëndimore: “Pasi u zgjodhëm, askush nuk donte të fliste me ne”, na thotë ai. Nga mbërëmja e 30 gushtit, ne dërguam shtatë letra në përfaqësitë diplomatike, por askush nuk donte të na shihte. Ne ishim të mbërthyer nga etiketimet: “pro-rusë”, “pro-serbë”. U tha që po rrezikonim stabilitetin e rajonit, se Mali i Zi nuk ishte më një shtet i sigurt”.

Shumë shpejt, atij ju desh të qetësohej. Ende të varur nga Kisha, udhëheqësit kryesorë të mazhorancës së re u mblodhën në manastirin e Ostrog më 8 shtator për të miratuar një sërë angazhimesh që synojnë perëndimorët: forcimi i bashkëpunimit me NATO, zbatimi i reformave të nevojshme për pranimin në Bashkimin Evropian, respektimi i Kushtetutës dhe simboleve të shtetit (flamuri, himni), moskthim të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Pas këtyre marrëveshjeve të Ostrogut, ambasadori gjerman priti z.Krivokapiq: “Nuk

ishte një takim zyrtar; nuk lëshuam asnjë deklaratë. Unë i tregova për përvojën time në vendin e tij. I thashë se Helmut Kohl ishte për mua mishërimi i demokracisë, çka unë ëndërroja për Mal të Zi dhe për çka mund të aspironim tani”.

Z.Gjukanoviq, njohës i modeleve perëndimore, vizitoi Berlinin më 7 tetor. Ai na përsërit paralajmërimin që u drejtoi kundërshtarëve të tij: “Nëse mazhoranca e re rrezikon shtetin, atëherë do të kishte probleme me të gjithë ata që respektojnë për dhjetë shekuj pavarësinë e Malit të Zi. Dhe ne do ta mbrojmë këtë me të gjitha mjetet. Nuk do t’i injorojmë ndërhyrjet që janë vërejtur me sy të lirë që nga viti 2016, kur Rusia vendosi ta bllokojë anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. Ne e shohim këtë ndërhyrje në praninë e fortë të parave të paligjshme, në ndikimin e fortë mediatik të Moskës përmes Beogradit dhe në përfshirjen e shërbimeve të inteligjencës”.

Vetëm më 4 dhjetor u bë e njohur përbërja përfundimtare e qeverisë alternative. Vështirësia kryesore qëndronte në emërimin e mundshëm si ministra të zyrtarëve të Frontit Demokratik – përbërësi kryesor i koalicionit “Për të ardhmen e Malit të Zi”, i cili bashkon 27 nga 41 deputetët që formojnë mazhorancën e re. Ata dyshohen për lidhje me Rusinë dhe Serbinë. Andrija Mandiq dhe Milan Knezheviq u dënuan me pesë vjet burg në rastin e “grushtit të shtetit” misterioz që synonte ta përmbyste pushtetin në 2016. Ata denoncuan këtë komplot dhe apeluan kundër vendimit. Por u desh të heqin dorë nga një pjesë e programit të tyre, si nga dalja prej NATO: “Donim një referendum për anëtarësimin, por nuk ka mazhorancë politike për këtë”, thotë z.Mandiq.

I preferuari i Perëndimit, atlantisti liberal Dritan Abazoviq zbulon hilen që ka gjetur: “Unë nuk mendoj se Uashingtoni ka diçka kundër një qeverie eksperte”. Parlamentari pranoi një qeveri “teknike”, me z.Abazoviq si nënkryeministër...Përfaqësuesit e zgjedhur të Frontit Demokratik nuk reagojnë, duke shpresuar të përparojnë në çështjet përparësore në sytë e tyre: hapësirë për ta reformuar thellë administratën dhe për t’i dhënë fund metodave të pushtetit të trashëguara nga komunizmi, thotë Mandiq. Ne gjithashtu duam t’i japim fund diskriminimit kundër serbëve, të cilët ishin përjashtuar nga postet publike. Në fund, ne duam të luftojmë kundër pandëshkueshmërisë dhe ta kalojmë një ligj lustracioni për t’i larguar njerëzit e korruptuar”.

Me krizën shëndetësore dhe pasojat e saj në ekonomi, kontradiktat e brendshme të mazhorancës së re dhe mbikëqyrjen e kudondodhur perëndimore, alternimi premon të jetë i vështirë. Sidomos pasi, në një klimë që është tensionuar shpejt me qeverinë, presidenti Gjulkanoviq synon t’i përdorë të gjitha privilegjet e tij. Ai filloi vitin 2021 duke refuzuar të shpallte tekstet e para kryesore të miratuara nga parlamenti, duke përfshirë heqjen e dispozitave më të diskutuara të ligjit për lirinë fetare. Ky gjest simbolik – i cili detyron parlamentin për një votim të dytë – tregon se, pas tridhjetë vjetësh në krye të DPS-së dhe vendit, presidenti nuk ka frikë të shkaktojë ndarje për ta ruajtur pozicionin e tij.

*Beograd

ARTA DADE, ISH-MINISTRE E JASHTME E SHQIPËRISË

Shqipërisë i mungon një e majtë sociale

Do të inkurajoja dhe mbështesja një lëvizje për një të majtë të vërtetë të çliruar nga dukuri të frikshme që e gërryejnë demokracinë dhe varfërojnë jetën shpirtërore dhe socialekonomike të njerëzve, që frenojnë përparimin dhe e mbajnë vendin larg familjes së vlerave.

INTERVISTOI: ARDIT RADA

Përmes një interviste të rrallë, ish-ministrja e Punëve të Jashtme të Shqipërisë rikthehet për publikun ku rrëfen qëndrimet e saj mbi zhvillimet e fundit në rajon. Arta Dade shprehet se i takon Shqipërisë si vendi amë që ta ndihmojë Kosovën me përvojën e saj në proceset integruese, por edhe me zbatimin e marrëveshjeve dhe duke krijuar lehtësira për qytetarët e saj. Për 'Le Monde Diplomatique' në gjuhën shqipe, Dade komenton edhe marrëdhëniet Kurti-Rama, apo ndikimin që pritet të ketë administrata Biden në faktorin shqiptar. Por, a do të rikthehet zonja Dade në politikën aktive? Ish-ministrja sqaron më poshtë ambiciet e saj, si dhe eksperiencën në krye të MPJ.

— Znj.Dade, Kosova sapo mbylli procesin zgjedhor ku Lëvizja Vetëvendosje mori një rezultat historik si partia më e votuar në proceset pas lufte. A mendoni se ky rezultat do të ndikojë për sfidat që Kosova ka në arenën ndërkombëtare, por edhe në politikat lokale, ku një masë kaq e madhe njerëzish ka besuar tek një parti dhe një njeri?

Arta Dade : Kosova është në një moment të rëndësishëm të historisë së saj moderne. Do të ecë përpara me konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe reformat demokratizuese, europianizuese, integruese në strukturat euroatlantike, apo do të shpenzojë energji duke u marrë me veten e dëmtuar për rrjedhojë imazhin e vet dhe perspektivën dhe aspiratat e brezit të ri. Ka pak ditë që ka dalë rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Kosovë dhe Vetëvendosja ka fituar bindshëm. Zhvillimet e vitit të fundit në Kosovë, situata me pandeminë, rrëzimi aspak i justifikuar i qeverisë Kurti I, ngjarjet me ndalimin dhe arrestimin e udhëheqësve të UÇK-së, debatet për shkëmbim territorësh me Serbinë, krijuan në Kosovë një situatë të paqëndrueshme dhe të pasigurisë për të ardhmen jo vetëm të politikës, por edhe të vendit. Besoj fuqishëm se fitorja e Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit do e risjellë Kosovën në shinat e zhvillimeve normale demokratike dhe të konsolidimit të shtetit të së drejtës. Ajo gjithashtu ka ringjallur shpresë në veçanti tek të rinjtë se Kosova do të jetë një shtet normal që do të qeveriset me përkushtim dhe seriozitet për të krijuar perspektivën për të rinjtë që ata ta shohin të ardhmen e tyre në vendin e tyre. Përtej faktit se qeveria e re do të përballet me probleme të vështira, besoj se vullneti dhe kapacitetet nuk i mungojnë për t'i kapërcyer ato me mbështetjen e BE-së dhe SHBA-ve sipas deklarimeve më të fundit nga të dy këta partnerë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Në arenën ndërkombëtare besoj se është një Kryeministër dhe maxhorancë e mirëpritur nga partnerët pa të cilët nuk mund të adresohen problemet e mprehta e në veçanti problemet integruese në strukturat euroatlantike që duket se janë ndalur edhe për



shkak të situatës së jashtëzakonshme me pandeminë edhe në BE dhe për rrjedhojë kanë zbehur shpresën dhe optimizmin për integrimin e vendit në BE dhe NATO. Kjo qeveri do të ulët si e barabartë me partnerët por edhe me Serbinë për të vazhduar bisedimet sipas një koncepti të ri e konkluduar me njohjen e ndërsjellë. Mesazhet që vijnë nga administrata e re e Presidentit Biden janë premtuese për një angazhim serioz të kësaj administrate për të vazhduar sipas të njëjtit koncept e vizion që ata kanë për Kosovën dhe rajonin në përgjithësi.

— Si do t'i komentoni marrëdhëniet e vështira që kanë kryeministri Rama me homologun e tij të ardhshëm Kurti? A ka pasur ndonjë precedent të mëparshëm ku liderët e dy vendeve kanë pasur një marrëdhënie të tillë? Si e ka trajtuar Shqipëria Kosovën gjatë kohës që ju drejtonit Ministrinë e Punëve të Jashtme?

Arta Dade : Besoj se qeveria që do të dalë pas zgjedhjeve të 25 Prillit në Shqipëri duhet të reflektojë rreth

ndonjë problemi që është shfaqur më shumë në nivel të retorikës sesa realisht ekziston. Marrëdhëniet midis Kryeministrave të Kosovës dhe Shqipërisë asesi nuk mund të jenë marrëdhënie personale, ato i tejkalojnë këta kufij, sepse qeveritë patjetër që duhet të mbajnë në vëmendje vullnetin e popullit që qeverisin e për rrjedhojë këto marrëdhënie institucionale i shërbejnë afritit të mëtejshëm të shqiptarëve në të dyja anët e kufirit dhe pa mëdyshje që kjo ka ndikimin e vet te shqiptarët e Luginës së Preshevës, të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi. Ka patur hapa pozitive me mbledhjet e përbashkëta të qeverive, por është e domodoshme që angazhimet e marra përmes marrëveshjeve të nënshkruara të përditësohen dhe të zbatohen. Mendoj që është bërë pak për t'i zbatuar marrëveshjet e nënshkruara. Po të kthehem pas në vite. Mendoj që Shqipëria ka bërë shumë për Kosovën sikurse edhe i takonte të bënte – para konfliktit, gjatë konfliktit dhe pas luftës – duke e mbështetur pa rezervë Kosovën dhe shqiptarët e Kosovës, por edhe qeveritë e njëpasnjëshme, përtej faktit se cila forcë politike ka

qeverisur dy vendet tona respektive. Asokohe Kosova nuk ka patur Ministrinë e saj të Punëve të Jashtme dhe shpesh ne na është dashur të flasim për zhvillimet pozitive atje dhe t'i mbrojmë arritjet të cilat nuk ishin vetëm të klasës politike, por ishin më së pari të popullit të Kosovës, madje edhe të partnerëve ndërkombëtarë. Gjithashtu trupi diplomatik i MPJ së Shqipërisë udhëzohej periodikisht si të punohej me ndërkombëtarët në veçanti në organizatat shumëpalëshe ku Kosova kishte nisur përpjekjet për t'u anëtarësuar por edhe me kancelaritë perëndimore të rëndësishme. Jo vetëm në kohën kur unë drejtoja MPJ, por edhe më pas ndër vite si nënkryetare dhe kryetare e Komisionit të Politikës së Jashtme kemi mbështetur çdo nismë të Komisionit të Punëve të Jashtme të Kosovës në organizim edhe të konferencave parlamentare rajonale, apo dhe me gjerë. Bashkëpunimi me Albin Kurtin, kur ai drejtoje këtë komision, por edhe me kolegë të tjerë, ka qenë i shkëlqyer. Në AP të Këshillit të Evropës, por edhe në AP të OSBE-së, ku kam qenë e pranishme për katërmbëdhjetë vjet, përpjekjet që Kosova të

mos mbetet në harresë kanë qenë në vëmendje për çdo çështje që diskutohet për rajonin e kjo ishte edhe më e dukshme në debatet me delegacionet nga Rusia apo Serbia, por edhe individë të vendeve që nuk e kanë njohur ende Kosovën.

Naiviteti i Ramës

— Çfarë mendimi keni për projektin e minishengenit që duket se është “molla e sherrit” mes dy administratave? Çfarë këshille do t'u jepnit dy kryeministrave nisur nga eksperiencia juaj e gjatë në politikën e jashtme?

Arta Dade : Projekti i minishengenit është një projekt i vjetër që është riaktivizuar nga ana e Serbisë për të krijuar përshtypjen se ata janë të interesuar për bashkëpunimin rajonal, pa Kosovën, dhe Serbia rreket të luajë rol udhëheqës pa hequr dorë nga ëndrra e saj e kahershme për Serbinë e Madhe, nxitur e mbështetur edhe nga Kremli. Më e pakta që Kryeministri i Shqipërisë bëri është naivitet duke

e mbështetur këtë projekt dhe duke e bërë Shqipërinë vend mikpritës për një nga takimet në këtë kontekst pa pjesëmarrjen e Kosovës dhe në prani të Presidentrit Serb mund të ishin shmangur retorikat në distancë me liderët e Kosovës që nuk pranuan të bëhen pjesë e këtij projekti dhe kjo ishte në të drejtën e tyre edhe për faktin që Kosova dhe pesë vendet tona janë pjesë e projektit të procesit të Berlinit që i dha një impuls të ri bashkëpunimit rajonal.

Nën kujdesin e Kancelares Merkel dhe vendeve të tjera të BE-së, ky proces shënoi disa rezultate pozitive si krijimi i fondit për Ballkanin Perëndimor, apo zyra për bashkëpunimin rinor, si edhe projekte të koordinuara të infrastrukturës dhe konjektivitetit. Asgjë e mirë nuk vjen nga mbivendosja e nismave veç se ka një spostim të vëmendjes nga fokusi kryesor ndjekja e agjendës europiane në proceset e integritimit. Përveç procesit të Berlinit vendet që ftohen në të ashtuquajturin miniSchengen ka kohë që janë pjesë e nismave të rëndësishme rajonale dhe pjesë e projekteve të rëndësishme dhe dobiprurëse për secilin vend që duhet të manifestojë vullnet të sigurt për bashkëpunim dhe të vetëdijësohet për të pranuar realitetet e reja në rajon. Pa kontributin e secilit vend përfshirë, Kosovën dhe Serbinë, projektet e konjektivitetit e të lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerëzve, bashkëpunimi rinor, krijimi i zonës ekonomike rajonale do të ishte e vështirë të realizoheshin.

Nuk besoj se është vendi për të dhënë këshilla sepse në përgjithësi kryeministrat e këtyre trevave nuk e njohin mirë institucionin e Këshilltarit. Në çështje të politikës duhet jashtme unë mendoj se qeveritë duhet të bashkëpunojnë dhe të koordinohen e jo të bëjnë skena të papranueshme të zënkave provinciale. E Shqipëria si vendi amë duhet të jetë më e kujdeseshme për të ndihmuar Kosovën përmes zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara e krijimit të lehtësirave për akses në portet e Shqipërisë apo edhe me përvojën pozitive me proceset integruese.Madje edhe duke trajtuar mangësitë tona në këtë proces në mënyrë që Kosova të mos përsërisë të njëjtat gabime.

Shqipëria do e ndihmonte Kosovën duke qenë vet një shtet me institucione demokratike të konsoliduara, me standarde të përmblusura në proceset integruese, me rezultate të prckshme në luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit si edhe një shtet me politika sociale dhe ekonomike që krijojnë shpresë dhe perspektivë me qëllim që brezi i ri të qëndrojë e të jetojë e të ndërtojë të ardhmen në vendin e tij.

Të lëvizim nga Kosova, por mbelemi në rajon... Në Maqedoninë e Veriut duket se BDI ka shtyrë disa procese të rëndësishme për shqiptarët, çfarë mendimi keni për situatën politike atje dhe për rolin e Tiranës?

Arta Dade : Mendoj se Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë marrëdhënieve me Maqedoninë e Veriut jo vetëm për faktin që jemi fqinjë, por në veçanti për shqiptarët që jetojnë atje që prej pavarësisë së saj nga ish Jugosllavia. Është e vërtetë që BDI dhe Ali Ahmeti dhe në përgjithësi shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë arritur disa rezultate pozitive si në përfaqësimin politik ashtu edhe në nivele të administratës civile dhe përfaqësimit në strukturat diplomatike. Shqiptarët në RMV kanë qenë në vazhdimësi jo

vetëm faktor shtetformues por edhe faktor stabiliteti dhe integritimi në strukturat euroatlantike. Ata vendin e tyre, Maqedoninë e Veriut, kanë aspiruar e kanë punuar ta shohin pjesë të BE-së dhe te NATO-s. Sigurisht që Tirana zyrtare i ka mbështetur përherë proceset për integrim euroatlantik si edhe kërkesat e drejta të shqiptarëve atje dhe ka kërkuar që Marrëveshja e Ohrit të zbatohet në të gjitha pikat e të shkohet edhe më tej. Gjithashtu Tirana ka shkujarruar ndonjë përpjekje të ekstremizmit që do të dëmtonte vet arritjet e shqiptarëve në RMV. Dëshiroj dhe uroj që Maqedonia e Veriut të zgjidhë problematikën që i është krijuar së fundmi me fqinjin e vet lindor sikurse me kurajo dhe maturi shembullore zgjidhi çështjen e emrit me Greqinë.

– Në Mal të Zi duket se mbetet një situatë problematike për shqiptarët, sidomos me qeverinë e re pro-serbe dhe për faktin që njeriu që e bëri

ARTA DADE

të mundur këtë ishte shqiptari Dritan Abazović. A mendoni se Tirana zyrtare duke u rreshtuar haptazi me një krah politik atje dhe me një parti shqiptarësh bëri veprimin e duhur?

Arta Dade : Me Malin e Zi kemi patur marrëdhënie të ngushta të bashkëpunimit dy-palësh, rajonal dhe shumë-palësh dhe është kënaqësi kur shikon se si vendet e rajonit dhe fqinjët tanë punojnë në projekte të përbashkëta dhe përmblusim qëllime të përbashkëta sikurse integritimi i vendeve tona në NATO dhe BE si garanci për mbrojtjen e vlerave demokratike dhe nxitjen e bashkëpunimit në fushat socialekonomike dhe të infrastrukturës.

Situata në Malin e Zi po ndiqet me vëmendje dhe shqetësim edhe nga partnerët që e kanë mbështetur këtë vend të integrohet në NATO dhe të përparojë në agjendën e vet europiane për t’u bërë plotësisht pjesë e BE-së. Shqiptaret atje kanë mbështetur forcat pro-perëndimore dhe kanë mundur të orientohen në drejtimin e duhur. Ata janë pjesë e zhvillimeve pozitive dhe integruese të Malit të Zi dhe me qeveritë praardhëse kanë mundur të zgjerojnë hapësirën për të fituar më shumë të drejta si ne nivel të qeverisjes qendrore, sikurse përdorimi i gjuhës shqipe në parlament, ashtu edhe të qeverisjes vendore. Shqipëria e në veçanti e majta kanë mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin e partive shqiptare me qeveritë progresiste ndër vite që prej shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Mali i Zi ka qenë i palëkundur në përparimin e tij për anëtarësim në NATO dhe agjendën europiane. Me zhvillimet e fundit, me një qeveri pro-serbe, situata mund të ndryshojë. Qëllimet e Beogradit për hegjemoni në Ballkan nuk kanë ndryshuar. Aleati i tij kryesor, Kremlini, ka ndërhyrë në proceset demokratike në Mal të Zi. Uroj që të mos ketë procese regresive në këtë shtet fqinj. Shqiptari Dritan Abazović, që e mban në këmbë këtë qeveri, duket se ka dhënë garanci që nuk do të lejojë kthim pas në proceset që janë në interes të Malit të Zi, por edhe në dobi të një rajoni të stabilizuar, me më shumë siguri dhe të integruar në BE. Unë shpresoj që ai të ketë forcë ta bëjë këtë. Lidhur me ndikimin e Tiranës zyrtare mendoj se pati një përpjekje të dështuar nga ana e Kryeministrit të Shqipërisë për të bindur Abazovićin të bëhej pjesë e një koalicioni që nuk do e ndryshonte kursin pro-perëndimor të Malit të Zi. Në këto raste mendoj se këto takime duhet të përgatiten më mirë dhe të

merret informacion paraprak i saktë në mënyrë që autoriteti i shtetit të mos cenohet.

Partizimi i integritimit evropian

– Të kthehemi në Tiranë... Besoj se është edhe në interesin tuaj sa i përket procesit të integritimit. Kryeministri Rama thotë se ngadalësimi i procesit ka ndodhur si pasojë e dinamikave të BE. A mendoni se qasja që duhet të ketë qeveria jonë dhe politika jonë e jashtme është lënia e përgjegjësisë dinamikave të brendshme të BE?

Arta Dade : Procesi i integritimit të Shqipërisë është i tejzgjatur dhe ka patur problematikë të mprehtë në vazhdimësi. Ne e kemi nisur këtë proces shumë më përpara se vendet e tjera të rajonit dhe tani duket se kemi mbetur të fundit. Ne nuk kemi patur as probleme të identitetit tonë si shtet, as jemi prekur nga luftëra të përgjakshme sikurse është rasti i vendeve që u pavarësuan prej ish-Jugosllavisë. Në momente të veçanta kur është dashur që ky proces të shtyhej përpara përpjegjeshmëria e klasës politike ka shkaktuar ndalje te procesit ose edhe më keq kthim pas. Jemi në fazën që ky proces nuk ka përparuar që prej 2014 kur Shqipëria mori statusin e vendit kandidad.

Përtej problematikës së mprehtë brenda vetë BE-së përparimi dhe përmblusja e standardeve është në dorë të vendit që aspiron t’i bashkohet klubit të BE-së. Ka patur edhe momente të tjera kur BE-ja ka përjetuar kriza por procesi i zgjerimit nuk është ndalur. Në asnjë vend tjetër procesi i integritimit nuk është politizuar dhe nuk është dominuar nga fryma partizano-partiake sa në Shqipëri. Perspektiva europiane e Shqipërisë por edhe e rajonit është instrumenti që i beri popujt e rajonit të lënë pas konfliktet e përgjakura dhe të bashkëpunojnë për këte projekt madhor. Secili vend ka ditur të gjejë veten dhe të perfitojë nga ky proces si në nivel të thithjes së investimeve të huaja apo të fondeve përmes programeve që kanë si pikësynim zhvillimin e vendeve aspirante për të përmblusur standartet e kërkuara. Druaj të them nëse Shqipëria e ka bërë mirë këtë.

Perspektiva europiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë, duhet të vazhdojë të mbetet thelbësore për stabilitetin dhe zhvillimin e rajonit. Patjetër që vlerësohet progresi i bërë në reforma politike dhe ekonomike apo reforma në drejtësi në rastin e Shqipërisë, por ka ende vende që nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për të përmblusur kriteret dhe kushtet në rrëtimin e tyre drejt anëtarësimit. Ka ende shqetësim se Ballkani Perëndimor vazhdon të ndeshet me sfida ende të pafituara që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, reforma administrative, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, lirinë e shprehjes dhe të medias si çështje që çënojnë një shoqëri demokratike dhe ekonomite funksionale. Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë janë në prag; mënyra se si do të zhvillohen ato e si dhe sa do të përmblusën standartet ndërkombëtarisht të pranuar për zgjedhje të lira do të jetë edhe moment vendimtar për të hapur dritën jeshile që Shqipëria të nisë negociatat për anëtarësim e të organizohet konferenca e parë ndërqeveritare me Komisionin Europian.

Zvarritjet në këtë proces sjellin lodhje tek qytetaret dhe humbje të shpresës, sikurse është rasti i liberalizimit të vizave për në zonën Schengen të qytetarëve të Kosovës, por kjo gjithashtu ka sjellë spekulime nga ana e qeverive për të justifikuar dështimet në përmblusjen e premtimeve dhe programeve që i kanë sjellë në qeverisje duke bërë me faj BE-në dhe problematikën brenda saj .

– Zonja Dade, si do ta gjykoni që pikërisht në këtë kohë të rëndësishme Shqipëria vendosi të kishte një zv.Ministër në krye të MEPJ, dhe një zv.ministër pa eksperiencë. A mendoni se kjo ndikoi negativisht, apo politika e jashtme nuk lidhet me individin që është në krye të institucionit?

Arta Dade : Mendoj se Genti e zgjidhi vetë këtë dilemë duke dhënë dorëheqjen. Ideja e Kryeministrit për të përfshirë në kabinetin qeveritar një personalitet nga Kosova nuk mund të jetë e qortueshme, përkundrazi. Përzgjedhja duhej të kishte qenë më e pranueshme për një post kaq të rëndësishëm. Personalitetet nga Kosova që do i bënin nder detyrës së Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë nuk kanë munguar.

– Si mendoni se do të ndikojë zgjedhja e Joe Biden në politikat e rajonit tonë?

Arta Dade : Administrata Amerikane ka patur përherë vëmendje serioze ndaj rajonit në veçanti në momentet e konflikteve të përgjakura shkaktuar nga Millosheviqi dhe Serbia ku SHBA-të u angazhuan edhe ushtarakisht për t’i dhënë fund masakrave dhe genocidit në veçanti në Bosnje dhe Kosovë. Administrata Biden shpresoj të ketë angazhim më të madh se vitet e fundit në Ballkanin Perëndimor duke mbështetur përshpejtimin e integritit të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi në Bashkimin Europian, por edhe të Kosovës në hapat e saj drejt proceseve integruese euroatlantike edhe si kundërpërgjigje e përpjekje që bën Rusia që ky rajon të mbetet në qerthullën e konfliktualitetit ndëretnik e fetar dhe të pengohet në përparimin drejt Bashkimit Europian duke nxitur destabilitetet me qëllim kontrollin e Moskës mbi vendet që mendohet se janë satelitë të saj si edhe më gjerë. Prania amerikane në rajon tani bëhet edhe më imperative me zhvillimet e fundit në Malin e Zi por edhe për t’i dhënë një impuls të ri dialogut Kosovë-Serbi për ta përmbyllur atë në njohjen e ndërsjellë të të dy shteteve sikurse ishte dhe mesazhi i Presidentit Biden për Vuçiq i cili tërthorazi ka bërë deklarata të papranueshme lidhur me Kosovën. Pa bashkëpunimin e SHBA-ve dhe BE-së për të përshpejtuar zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi do jetë vështirë që të kemi rezultat të pritshëm në kohën e duhur aq më tepër që dihet se Serbia diktohet nga interesat ruse në rajon.

Njerëzit pranë Administratës Biden në vijimësi janë shprehur kundër idesë së shkëmbimit të territoreve ofruar si zgjidhje nga Beogradi dhe mbështëtur edhe nga një numër i kufizuar politikësh shqiptarë andej e këtij kufirit si një çështje që do të hapte probleme të tjera të mprehta etnike e do ta kthente rajonin në ciklin e krizave të njëpasnjëshme. Kjo edhe njëherë konfirmon qartazi që SHBA-të nuk do lejonin që ky rajon të rrëshqasë drejt destabilitetit e do vazhdojnë të punojnë që vendet të përmblushin standartet e shteteve dhe shoqërive me demokraci të konsoliduar për t’u integruar

plotësisht në BE sikurse u punua që Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut të jenë anëtare të NATO-s.

Çfarë mendimi keni për partitë e reja që janë regjistruar në këto zgjedhje? A mendoni se ndikon në acarimin e marrëdhënieve dhe fakti që LVV ka themeluar parti edhe në Tiranë?

Arta Dade : Është zhvillim për t’u përshëndetur që në këto zgjedhje garojnë parti të reja si nisma Thurje dhe LVV-ja. Votuesit në Shqipëri do kenë edhe alternativa të tjera për të votuar veç partive që kanë dominuar skenen politike në 30 vjet. LVV-ja e Albin Kurtit ka ndikim në Shqipëri në veçanti tek grupimi i të rinjve që nuk e gjejnë veten tek partite tradicionale si edhe tek votues me bindje të majta që mendojnë se një forcë politike që përfaqëson realisht të majtën me vokacionin e saj social dhe solidaritetin njerëzor nuk ekziston.

– Pas 30 vjetesh kontribut në PS a do të pranoni një ofertë nga një parti tjetër apo? Apo, a ka plan Arta Dade të rikthehet në politikë qoftë edhe përmes themelimit të një lëvizje të re?

Arta Dade : Unë ndjehem mirë dhe ka qenë nder për mua të kem punuar me përkushtim për të majtën e re shqiptare që i dha vendit alternativën më të dashur dhe të parapëlqyer ndër vite duke kuruar plagët social-ekonomike në vend dhe duke e çuar vendin përpara drejt proceseve integruese duke u integruar edhe vetë në strukturat partiako-politike rajonale, europiane dhe ndërkombëtare. Nuk do e ndërroja Partinë Socialiste e as votuesit e saj me asnjë forcë tjetër politike në vend. Flas për atë parti që identitetin e kishte realisht të majtë socialdemokrat dhe vendin e çoi përpara me programin e saj. Nuk jam larguar nga politika të cilën e ndjek me të njëjtin pasion dhe kjo më bën që t’i shoh gjërat me syrin kritik. Do të inkurajoja dhe mbështesja një lëvizje për një të majtë të vërtetë të çliruar nga dukuri të frikshme që e gërryejnë demokracinë dhe varfërojnë jetën shpirtërore dhe socialekonomike të njerëzve, që frenojnë përparimin dhe e mbajnë vendin larg familjes së vlerave.

– Në fund donim një mesazh nga ana juaj për partitë shqiptare në rajon. A është akoma ëndrra për t’u integruar në BE një ide e qendrueshme apo tezat e bashkimit kombëtar do të marrin më shumë terren?

Arta Dade : Sikurse u shpreha më sipër partitë shqiptare në të gjitha trojet ku banojnë shqiptarët janë shprehur qartazi e pa mëdyshje për vokacionin e tyre perëndimor dhe integrimin e vendit të tyre në Bashkimin Europian. Ideja e bashkimit kombëtar nuk është kundërthënëse me idenë e integritimit të vendeve tona -Shqipërisë e Kosovës në BE, por edhe vendeve të tjera ku jetojnë shqiptarë si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe shqiptarët në Serbinë jugore. Besoj se më shumë se sa flasin për Bashkim Kombëtar, Shqipëria e Kosova duhet të punojnë që të zhvillohemi së bashku ekonomikisht e të përmblusim standartet për të përfunduar rrugëtimin drejt BE-së ku bashkohemi në familjen e madhe të vlerave. Nëse Europën do e sjellim në vendet tona atëherë kufijtë do të jenë të papërfillshëm. Duke qenë shtete që u krijojnë shqiptarëve hapësira socialekonomike e demokratike që vendi të mos braktiset, ne do të mund të mbrojmë më mirë interesat e shqiptarëve kudo ku jetojnë në rajon.

MINORITETET E DONALD TRUMPIT

Votuesit e ofenduesve të tyre

Si shpjegohet që z.Donald Trump fitoi vota nga minoritetet të cilat i kritikoi vazhdimisht gjatë mandatit të tij? Mbase nga fakti që individët nuk e përkufizojnë vetveten vetëm nga "raca" dhe se ata nuk e gjejnë domosdoshmërisht veten në përkufizimin e racizmit, propozuar nga disa akademikë.

NGA MURTAZA HUSSAIN*

Më vitin 2010, votuesit e Torontos, një nga qytetet më shumë diversitet etnik në planet dhe mbështetës i së majtës, zgjodhën një racist të pandreqshëm si kryebashkiak. Tip i vrazhdë dhe i çuditshëm, djalë i një biznesmeni miliarder, Robert Ford kishte krijuar një figurë të vetën përmes përlëshjeve me anëtarët e tjerë të këshillit të qytetit dhe tiradave të tij helmuese kundër pothuajse çdo grupi pakicash. Dikush do të kishte menduar se fushata e tij fitimtare ishte kryer nga një valë e fuqishme e inatit të të bardhëve kundër diversitetit. Megjithatë ishin emigrantët dhe pakicat, domethënë popullatat që shënjstroj, që ia mundësuan ngritjen në pushtet. Pavarësisht nga dhuna e papërpunuar e fjalëve të tij, ose ndoshta për shkak të saj, një pjesë e konsiderueshme e njerëzve që ai urrente e adhuruan përsëri. “Përdorues i drogës, i trashë dhe i pasjellshëm – megjithatë ai u bë kryetari i bashkisë. Ford është një antihero në këtë histori sfiduese suksesi. Ai thotë gjëra që njerëzit pa të drejta dëshirojnë t’i thonë”, nënvizon revista Toronto Life (29 Shtator 2014) lidhur me popullaritetin mahnitës të këtij personazhi. “Askush nuk i mbron njerëzit aq shumë sa unë, pavarësisht racës që kanë”, shpërtheu ky i fundit një ditë kur ishte i dehur, përpara se ta kundërshtonte veten duke thënë se “Unë jam njëriu më racist këtej përreth. Unë jam kryetari i bashkisë së Torontos ». Ndërsa media konkurronte në indinjatë për ta shkatërruar racizmin e tij, “Trumpi kanadez” prishi rrjetet e tyre analitike duke fituar 80% të votave në periferitë e klasës punëtore të popullara nga punëtorë emigrantë. Unë po jetoja në Toronto në atë kohë dhe isha si gjithë miqtë e mi mbështetës të Fordit – pa qenë vetvetja, duhet thënë. Edhe sot, disa njerëz kujtojnë me nostalgji ato kohëra kur pasi e hasnin në një pikë karburanti ose në dalje të një fast-foodi, pinin kanabis me të. Ata nuk i kushtuan vëmendje backgroundit social të Fordit, as përdorimit të tij të drogës, sharjeve racore ose paaftësisë famëkeqe, duke kujtuar vetëm njeriun e përditshëm, në dukje të afërshëm dhe më pranë tyre. Sa më shumë që media e sulmonte atë, aq më shumë ai ngrihej në vlerësimin e mbështetësve të tij. Ford kishte pak për t’i ofruar atyre në aspektin e agjendës politike ose qeverisjes së mirë, por personaliteti i tij i çuditshëm ishte, siç e shprehu Toronto Life, si një “gisht i mesëm” i tundur nën hundën e një klase politike që perceptohej si arrogante, hipokrite dhe e vetëkënaqur. Historia e Ford, i cili vdiq nga kanceri në 2016, përmendet në zgjedhjet presidenciale të SHBA-së. Sondazhet e diskutueshme të daljes së rezulateve nga kutitë e votimit tregojnë një rritje në votimin e Trump-it nga minoritetet. Pavarësisht katër viteve të asaj që shumë vëzhgues e cilësojnë si racizëm të hapur, z.Donald Trump ka mbledhur më shumë vota në favor të tij midis njerëzve me ngjyrë (katër pikë më shumë) dhe latino-amerikanëve (tre pikë më shumë) sesa kishte bërë në vitin 2016. Studimi i kryer nga Edison Research për New York Times sugjeron gjithashtu se ai fitoi mbështetjen e një të tretës së elektoratit të lindur



në Azi, një proporcion i mjaftueshëm për të hedhur poshtë analizën që politikat e tij i drejtohen vetëm kufijve të ngushtë të nacionalistëve të bardhë. Si të gjithë kandidatët demokratë për shumë vite, z.Joseph Biden ka marrë një shumicë të bindshme votash midis grupeve demografike jo të bardha. Në zonat kyçe urbane të Filadelfias, Milwaukee, Atlanta ose Phoenix, votuesit afrikan-amerikanë, latinë dhe aziatiko-amerikanë i dhanë një rezervë votash vendimtare për fitoren e tij. Sidoqoftë, duke pasur parasysh faktin se z.Trump dukej të ishte racist dhe që progresistët prisnin të korrin përfitimet e transformimeve afatgjata demografike, ia vlen të pyesni veten sesi i nominuari republikan arriti të ruajë, apo edhe ta përmirsojë rezultatin e tij midis njerëzve me ngjyrë, latino-amerikanëve apo dhe të tjerëve. Një element i parë i shpjgimit mund të jetë se, për shumë votues jo të bardhë, sjellja e tij thjesht nuk përbush përkufizimin e tyre mbi racizmin. Kuptimi i racizmit shpesh luhet në përputhje me përkatësitë klasore, veçanërisht kur shprehet në mënyrë të paqartë, në formën e nënkuptimeve. Edhe kur z.Trump i mbush fjalët e tij me kode të ngarkuara racore në lidhje me imigracionin ose krimin, nuk është e qartë se amerikanët jo të bardhë ndihen personalisht të shënjestrar. Kampioni i “Amerika e para” mirëpret fansat e tij me ngjyrë dhe latinoamerikanë pa u treguar selektiv, për sa kohë që bien dakord për një imazh të caktuar të suksesit dhe konservatorizmit.

Udhëheqësit e majtë e shohin si detyrim mbështetjen e minoriteteve

Idea e votimit sipas blloqeve demografike që ndahen sipas kategorive racore ka qenë gjithmonë një mit. Nëse rezultatet e zgjedhjeve të fundit presidenciale të SHBA-së do të mund të sheshojnë iluzionin se popullatat jo të bardha përbëjnë grupe interesi monopolit, do të përbënte progres. Z.Trump, për shembull, ka përfituar shumë nga mbështetja e elektoratit kubano-amerikan në MiamiDade County,

Florida, një komunitet i asimiluar me Latinos, por shpesh i identifikuar si i bardhë, dhe që duket se ka vendosur anti-komunizmin në krye të rendit të prioritetëve të tij elektorale. Nga ana e tyre, udhëheqësit e majtë shpesh kanë përdorur akuzën e racizmit si një trampolinë retorike për ta vendosur veten si miqtë e vetëm të vërtetë të pakicave racore dhe për ta konsideruar mbështetjen e tyre si detyrim. Por strategjia është konsumuar. Midis kategorive të njohura të të gjitha origjinave, lodhja po rritet përballë politikanëve të paafte për ta frenuar përkeqësimin e kushteve të tyre të jetesës dhe dyshimin se i shikojnë nga lartë. Një stereotip që media e ekstremit të djathtë po përpiqet të përkeqësojë. Për shumë, kënaqësia kur panë këtë kastë duke bërë titur me tmerr është arsye e mjaftueshme për të votuar për kundërshtarin e parë, sado i papërmbytur të jetë ai. Ashtu si Ford disa vjet më parë, z.Trump shtyp furishëm të gjithë çelësat në tastierën e ndarjeve racore, duke shkelur pronat e devotshme të ligjëritimit të elitave. Brenda elektoratit të bardhë, tek i cili mbetet kryesisht i fituar, sjellja e tij duket se ka larguar disa nga mbështetësit, veçanërisht midis të diplomuarve, gjë që një luftë kulturore dhe politike gjithnjë e më e hapur u kundërvihet të bardhëve të tjerë që nuk kanë studiuar. “Pse votuesit në grupe minoritare që supozohen të jenë shënjestrë e racizmit të presidentit, jane duke mbështetur Trumpin?”, pyeti Musa Al-Gharbi, një sociolog në Universitetin Columbia, në një artikull të botuar një ditë para zgjedhjeve. Thjesht mund të ndodhë që disa nuk i shohin komentet e tij dhe veprimet e tij politike si raciste. Shumë shpesh akademikët vërtetojnë se diçka është raciste duke u përqëndruar ekskluzivisht në mënyrën në të cilën fjalët ose propozimet që nuk i pëlqejnë jehojnë midis njerëzve të bardhë. Nuk u shkon ndërmend t’i kushtojnë vëmendje rezonancës që mund të gjejnë brenda pakicave. Kur të ndodhin, rezultatet mund të jenë befasuese”. Retorika konservatore rreth imigracionit, policisë ose pasigurisë rezonon me votuesit me ngjyrë dhe latinë të paktën po aq sa me votuesit

e bardhë, ndonjëherë edhe më shumë. Në përpjesëtim, njerëzit me ngjyrë dhe latinë, si dhe aziatiko-amerikanët, janë më të prirur, në tema të caktuara siç është feja, të anojnë drejt anës konservatore sesa progresistët e bardhë, të cilët përbëjnë batalionet e mëdha të koalicionit zgjedhor. Kjo prire nuk është përkthyer kurrë në mbështetjen e shumicës për një kandidat republikan, lokal ose kombëtar, por përbën një kërcënim serioz për demokratët.

Në fillim të këtij viti, Al-Gharbi shkroi një tjetër artikull mbi mënyrën se si elitat progresiste e shohin rolin e tyre në formësimin e politikës racore dhe racizmit në Shtetet e Bashkuara: ata thonë se është përgjegjësia e tyre t’i mbrojnë pakicat kundë racizmit, e në të njëjtën kohë të kenë kontroll mbi përkufizimin e racizmit. Mënyra në të cilën disa demokratë kanë përdorur këtë çështje për të bllokuar rrugën drejt kërkesave sociale është vetëm një aspekt i problemit, siç shkruan Al-Gharbi në artikullin e tij, me titull “Kush duhet t’a përcaktojë se ç’është racizmi”. “Elitat e bardha – të cilët luajnë një rol kryesor në përcaktimin e racizmit në akademi, në media dhe në kulturën në përgjithësi – duket se e përcaktojnë racizmin sipas kritereve që përputhen me preferencat dhe përparësitë e tyre”, shkruan ai. Në vend që të merren me largimin e privilegjeve të racës së bardhë ose t’u japin më shumë të drejta atyre që nuk i kanë, ata duket se kanë të bëjnë kryesisht me konsolidimin e kapitalit shoqëror dhe kulturor në duart e të bardhëve “të mirë”. Pa dyshim, në nivel elektorat, kjo tryezë mund të sjellë disa kundërshtime. Është e padiskutueshme, për shembull, që sulmet e z.Trump ndaj racizmit nuk burojnë vetëm nga elitat e bardha: shumë prej aktivistëve, politikanëve ose protestuesve të zakonshëm që i bien këmbanave të alarmit për presidentin janë njerëz me ngjyrë ose latinë të cilët nuk i përkasin asnjë elite. Por, në një pikë, kritika e Al-Gharbi është e saktë.

Për elitat demokratike, që kullojnë nga vetëkënaqësia mbi këto çështje,

ekziston një interes i qartë për të përcaktuar “racizmin” në një mënyrë që u jep atyre një avantazh ndaj republikanëve. Kjo shpjegon pjesërisht entuziazmin me të cilin ata vlerësojnë risitë semantike që supozohet se marrin parasysh të drejtat e pakicave, edhe kur këto të fundit nuk e shohin domosdoshmërisht interesin. Duke u paraqitur si arbitër i asaj çka është racizëm dhe çfarë nuk është, progresistët e bardhë rrezikojnë ta politizojnë subjektin në avantazhin e tyre dhe ta heqin atë nga duart e të interesuarve, me qëllim që ta përdorin si armë në përballje me elitat e tjera të bardha. Ata kërcënojnë të zbrazin nga përmbajtja një koncept për të cilin minoritetet kanë nevojë për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e tyre përballë sulmeve që u janë nënshtruar. Ekziston një analogji, në një farë mase, midis këtij fenomeni kapje dhe akuzave të antisemitizmit të ngritura për të diskredituar çdo kritikë të politikës së jashtme amerikane ndaj Izraelit.

Aparati demokratik refuzon çdo reformë ekonomike ambicioze

Është e vështirë të thuash se çfarë përcaktoi zgjedhjen e njerëzve me ngjyrë dhe latinë që votuan për z.Trump. Ndoshta vlerësimi i virilitetit në retorikën presidenciale ka gjetur një jehonë të favorshme tek burrat të prirur për të bërë që interesat gjinorë të mbi-otërojnë mbi interesat e tyre të racës ose klasës. Sidoqoftë, ka pak dyshim që demokratët do të ishin në gjendje të përkryer ta kundërbalancojnë peshën e këtyre përcaktuesve kulturor nëse vendosin të miratojnë politika që do të përmirësonin materialisht kushtet e jetesës së klasave punëtore. Por masa e dobët e politikës simbolike të identitetit të ofruar nga demokratët siguron pak fuqi për pakicat, dhe shumë prej tyre nuk do ta pranojnë gjithmonë një regjim të tillë. Paga minimale prej 15 dollarësh në orë dhe mbulimi mjekësor për të gjithë do të ngushtonte ndjeshëm hendekun e pabarazisë racore, ndërsa përfitonte gjithashtu nga klasat e bardha punëtore. Megjithatë, për shumë vite aparati i partisë vazhdoi refuzimin e tij kokëfortë të çdo reforme ambicioze ekonomike ose shoqërore, duke u kënaqur me masa të vogla të padëmshme me shpresën se ato do të ishin të mjaftueshme për t’a hedhur. Sot rezistenca është thyer. Demokratëve nuk u mbetet gjë tjetër veçse të kalojnë reforma thelbësore, ndoshta duke menduar për pozicionin e lavdishëm në të cilin do të ishin gjendur po të mos kishin bërë fushatë kundër një presidenti të urreyer dhe krenar mbi paaftësisë e tij të zymtë përballë shëndetit, ekonomisë dhe katastrofës sociale. Nëse racizmi trajtohet jo si një atribut i qenësishëm i disa njerëzve, por si një mendim (i gabuar) që mund të korrigjohet, mbase do të ndihmonte në shuarjen e kësaj lufte të pafund kulturore e cila pengon mbrojtjen e interesave të përbashkëta ekonomikë.

ILUZIONI I RIKTHIMIT NË NORMALITET

Paranoja amerikane, si trashëgimi e Donald Trump

Presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara, z.Joseph Biden pohoi menjëherë dëshirën e tij për ta ribashkuar një vend të shkatërruar, ndërkohë që bën shkëputje dramatike nga trashëgimia e paraardhësit të tij. Arritja e këtyre dy qëllimeve në të njëjtën kohë do të jetë edhe më delikate, pasi republikanët dhe demokratët urrejnë njëri-tjetrin dhe hidhërimi paranojak i disave forcon tundimet disiplinore të të tjerëve.

NGA THOMAS FRANK*

Kështu, epoka e z.Donald Trump mori fund, në një apoteozë egoizmi, paaftësie dhe dhune. Presidenti miliarder kishte kursyer më të keqen për në fund. Pasi humbi zgjedhjet e 3 nëntorit 2020, ai refuzoi ta pranonte humbjen dhe bllokoi gjykatat me dhjetëra ankesa – të gjitha të refuzuara, përfshirë nga gjykatësit që ai vetë kishte caktuar – duke pretenduar se fitorja ishte e tij dhe se ‘i ishte vjedhur me një metodë të paspecifikuar’. Kjo teori absurde është bërë e vërtetë absolute për zyrtarët e zgjedhur republikanë, veçanërisht për më të rinjtë dhe më ambiciozët, të cilët nxituan ta përhapnin atë. Kulmi erdhi në 6 Janar, kur z.Trump u bëri thirrje mbështetësve të tij që të drejtoheshin në Capitol Hill në Uashington, ku parlamentarët ishin në procesin e vërtetimit të rezultatit të votimit.

I gjithë planeti e njeh pjesën tjetër: Turma sulmoi selinë e pushtetit legjislativ, në një shpërthim dhune me njerëz me veshje karnavalesh që pushtojnë shenjtoret e demokracisë amerikane. Disa bënë selfie në sallat e mermerit, të tjerët valëvitën flamurin e konfederatës dhe të tjerët bënë thirrje për vrasje. Pa dyshim që ata shpresonin se duke terrorizuar zyrtarët e zgjedhur do t’i ndihmonin z.Trump ta mbante pushtetin; përtej këtij objektivit të menjëhershëm, synimet e tyre mbetën të paqarta.

Është gjithmonë tronditëse të shohësh njerëz që kryejnë monstruoizitet në bazë të këtyre besimeve. Në këtë rast, sulmuesit në Capitol Hill kaluan një vijë të konsideruar të shenjtë nga shumica e amerikanëve. Dhe kështu ata arritën të bënin atë që askush nuk kishte bërë gjatë mandatit katër vjeçar të zotit Trump: ta futnin ndjenjën e turpit në radhët e Partisë Republikane.

Nga sot për nesër, figurat më të medi-atizuara konservatore kaluan nga mbështetja e sinqertë dhe e përzemërt për turmat e nxitura nga presidenti në një përpjekje të dëshpëruar për të shfajësuar veten nga sulmi në Capitol Hill duke e fajësuar, pa ndonjë gjasë shqetësimi, si “antifa”. Twitter ka prerë sqepin e përdoruesit të tij më të famshëm. Dhoma e Përfaqësuesve ka kërkuar “impeachment” për herë të dytë, e paparë në historinë e presidencës amerikane. Reagimi më i madh, megjithatë, erdhi kur bankat kryesore të vendit njoftuan se do ta ndalonin financimin e Partisë Republikane, qëllimi kryesor i së cilës ka qenë gjithmonë mbajtja e atyre bankave jashtë veprimit të ligjit.

Që këtu, filloi një ditë e re në Amerikë. Për një dekadë, shumë studiues të shquar parashikuan rënien e afërt të konservatorizmit, epokën e Reganit dhe “Grand Old Party”, të pushtuar në mënyrë të pashmangshme nga ndryshimet demografike, triumfi i progresivizmit multikulturor dhe ardhja e një brezi të ri amerikanësh. A është përmbyshja e kësaj profecie fundosja e trumpizmit në një mçal çmendurie dhe dhune?

Përgjigjja e një pyetjeje të tillë na detyron të marrim në konsideratë epokën Trump si një e tërë dhe të kemi një interes të veçantë për këtë kategori votuesish, të cilët, gjatë njëzet apo tridhjetë viteve të fundit, gradualisht janë larguar nga kampi Republikan për t’u bashkuar me elektoratin demokratik. Këta njerëz, unë i njoh mirë: ata janë njerëz me shije dhe arsim të mirë, për të cilët jeta është vetëm një seri

shkëlqimesh dhe kënaqësish. Po mendoj këtu për banorët e periferive më të pasura të bardha. Në njëqind qarqet me shkollat më të mira në vend, z.Joseph Biden mori 84% të votave. Në 100 qarqet me të ardhurat mesatare më të larta, ajo fitoi 57%. Tridhjetë vjet më parë, Republikanët fituan bindshëm në të dy kategoritë.

Krahasimi i peshës ekonomike të secilit territor me votën e votuesve të tij bën të mundur matjen e fenomenit. Zonja Hillary Clinton dikur mburrej se kishte pasur, pavarësisht humbjes së saj në zgjedhjet e vitit 2016, zonat më “dinamike” të vendit, ato që arritën në total “dy të tretat e produktit të brendshëm bruto të SHBA-së”. Epo, z.Biden bëri më mirë se kaq: qarqet e fituara nga kandidati demokrat përbëjnë 71% të aktivitetit ekonomik të SHBA, krahasuar me vetëm 29% në rastin e qarqeve pro-Trump.


Për monarkun e vjetër me rëndësi ishte t'i qetësonte gjakrat dhe të kujdesej që kjo çështje të mos përkeqësonte një situatë të brendshme tashmë të tensionuar nga pasiguritë në lidhje me trashëgiminë e tij të fronit dhe nga dëshira e princit trashëgimtar për ta lëkundur rendin.

Në Twitter, një rrjet social që ofron një ndalesë për mungesën e lirisë së shprehjes, sauditët janë të ndarë. Përderisa disa janë qartësisht në dobi të një përafrimi me Izraelin, duke



gjykuar ashpërsisht liderët palestinezë, të tjerët, përkundrazi, e refuzojnë me forcë atë përafrim dhe kërkojnë kthimin e Jeruzalemit Lindor tek palestinezët. Sipas miliarderit izraelito-amerikan Haïm Saban, vetë “MBS” është i vetëdihës për rreziqet e normalizimit të cilat mund ta “vrisnin atë nga Irani, nga Katari ose nga njerëzit e popullit të tij”. Pa harruar se anëtarët e tjerë të familjes mbretërore mund ta përdorin këtë pretext për ta parandaluar atë të ulet më vonë në fron.

Armiqësor ndaj Iranit, por edhe ndaj Vëllazërisë Myslimane, z.Mohammed Ben Zayed Al-Nahyan (“MBZ”) është lokomotiva tjetër e normalizimit me Izraelin. Por princi trashëgimtar dhe lideri de fakto i Emirateve të Bashkuara Arabe është më pak i kufizuar se homologu i tij saudit nga rendi i brendshëm shtëpiak. Pak në numër, të shkrirë në një popullsi të huaj që përfaqëson 90% të gjashtë milion banorëve të federatës, subjektet e saj janë mësuar gjatë dy dekadave të fundit me një normalizim hap pas hapi. Në pallatet e Abu Dhabit dhe Dubait, argjendarët izraelitë mbanin dyqane në mënyrë të diskrete.

Në konferencat kryesore të organizuara në të dy qytetet, nuk ishte e pazakontë të shohesh akademikë izraelitë të pranishëm në cilësinë : “vëzhgues të ftuar”. Në Prill 2011, pas disa muajsh lobimi intensiv, Abu Dhabi mirëpriste selinë e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Ripërtëritshme (Irena), pasi ishte për ta lejuar hapjen e një përfaqësie zyrtare izraelite në këtë institucion. Dhe nga muaji gusht ishte situatë ngazëlimi. Nuk kalon një javë pa njoftimin e mediave për takime dypalëshe ministrore ose për ngjarje emirato-izraelit. Këtu, Emirates Center for Strategic Studies and Research organizon një konferencë për përparimin e “paqes abrahamike” në Gji dhe në Lindjen e Mesme.

Aty, një agjencion komunikimi

organizoi në më pak se dy orë një takim midis grave udhëheqëse të dy vendeve – përfshirë një ish-oficere të lartë të ushtrisë izraelite. Në Dubai, hotelet kryesore presin me padurim zbarkimin e legjioneve të turistëve izraelitë, të cilët pritet të përfitojnë së shpejti liberalizimin e vizave. Në këtë qytet tregtar, një delegacion biznesmenësh të udhëhequr nga z.Erel Margalit, një emër i madh i kapitalit izraelit të sipërmarrjeve, u prit me nderime të larta. “Është si të biesh në dashuri”, tha edhe Youssef Abdulbari, prezantues yll i Dubai TV, pasi priti z.Margalit duke u ekzaltuar për rritjen e shkëmbimeve me izraelitët. Idilja është gjithnjë e më e pasionuar pasi të rinjtë e artë të Emirateve magjepsen nga Tel Avivi, netët festive të të cilit zëvendësojnë ato në Bejrut ose Kajro.

Po palestinezët në krejt këtë çështje? Ata që jetojnë në Emiratet e Bashkuara Arabe, ndonjëherë që nga vitet 1950, detyrohen ta mbajnë kokën ulur. Njëri prej tyre na thotë, me kusht anonimiteti, se po mendon të shpërngulet në Kuvajt, “një monarki e cila, ndryshe nga fqinjët e saj, refuzon çdo marrëdhënie me Tel Avivin përderisa nuk rimerren tokat palestineze”. Nëse autoritetet e Emirateve të Bashkuara Arabe këmbëngulin në ndihmën financiare dhe humanitare që vazhdojnë t'i japin palestinezëve, veçanërisht për ta luftuar Covid-19, diskursi është më pak i qartë për çështjen politike.

Për “MBZ”, një nga kundërvlerat për normalizimin mbetet braktisja nga Tel Avivi të planit të aneksimit të Bregut Perëndimor. Për këtë, Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu përgjigjet se është “shtyer”. Ky dialog i rremë i të shurdhërve, që synon ta ruajë pamjen e jashtme, do të zgjasë për aq kohë sa qeveria palestineze, që drejtohet aktualisht nga z.Mahmoud Abbas, do ta kundërshtojë një “paqe” jo aq detyruese për Izraelin.

Nëse ai pasohet nga një qeveritar më të përshtatshëm dhe pranon të

bëjë lëshime të mëtejshme, është e sigurt se asnjë ofertë pro-palestineze nuk do të vijë nga Emiratet. Për Abu Dhabi, z.Mohammed Dahlan, ish-udhëheqësi i Fatahut dhe ish-shefi i sigurisë parandaluese në Gaza, mbetet kandidati ideal. Duke jetuar në Dubai, në kundërshtim me z.Abbas, ai nuk e ka kritikuar marrëveshjen UAE-Izrael. Madje mendohet se ka qenë një nga arkitektët e saj. Në Bahrein, normalizimi paraqet një imazh që simbolizohet njëkohësisht rastet me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Arabinë Saudite. Sikurse të parët, edhe ishulli i vogël i Gjirit i qeverisur nga një monarki sunite, ka udhëhequr prej kohësh një normalizim de facto, duke shkuar aq larg sa ta presë një ambasadë jozyrtare izraelite që nga viti 2009. Por popullsia, me shumicë shiite, përshtatet më pak se ajo e Emirateve të Bashkuara Arabe. Përderisa represioni i ashpër kundër protestave popullore të 2011 dobësoi opozitën, kjo e fundit nuk është zhdukur, e sikurse një pjesë e opinionit publik saudit, ajo nuk është vonuar për ta dënuar përafrimin me Izraelin.

Të dhënat janë krejtësisht të ndryshme për Sudanin. Në një kontekst të tranzicionit të pasigurt demokratik, gjeneralët në pushtet kanë tre përparësi: që vendi i tyre të hiqet nga lista e mbështetjes për terrorizmin, që të mos vuajë më sanksione ndërkombëtare në lidhje me masakrat që ndodhën në Darfur dhe që të kanë qasje në fondet ndërkombëtare.

Normalizimi me Izraelin i garanton Khartoumit mbështetjen e Washingtonit për t'i arritur këto qëllime, por kjo shkakton tensione midis ushtrisë dhe koalicionit të partive dhe organizatave që udhëhoqën protestën kundër regjimit të z.Omar Al-Bashir më 2019. Ky koalicion beson se nuk i takon një qeverie në tranzicion të marrë një vendim të tillë. Por mbetet të shihet se deri ku do të shkojnë kundërshtimet.

NJË PERSPEKTIVË E NXITUR NGA BREXIT

Skocia ëndërron pavarësinë

Mbretëria e Bashkuar ndonjëherë duket si një lojë mikado, ku tërheqja e shkopit të "Bashkimit Evropian" do ta kërcënonte stabilitetin e grupit. I zyrtarizuar në fillim të vitit 2021, Brexit po i ringjall shpresat për autonomi në Edinburg. Skocia mbetet e kurthuar midis një të ardhme britanike që nuk e dëshiron më dhe pavarësisë të cilën nuk mund ta kërkojë ende.

NGA RORY SCOTHORNE*

Derisa po afrohet data 6 maj 2021, nëse Covid-19 nuk e ndryshon kalendarin elektoral, Skocia do të jetë në qendër të vëmendjes në dramën e pafund kushtetuese që Britania e Madhe i ka ofruar botës në vitet e fundit. Skenari veçse është shkruar: pavarësisht nga pandemia, zgjedhjet e gjashta të përgjithshme skoceze do të sillen, madje edhe më shumë se më parë, rreth çështjes së pavarësisë.

Jo vetëm nga fakti se Partia Kombëtare Skoceze (SNP) do të korre fitorën e katërt radhazi, por ngase si kurrë më parë pavarësia ka zënë pozitën e parë në shtatëmbëdhjetë sondazhe të njëpasnjëshëm. Nëse partia SNP e fiton shumicën, sikurse në vitin 2011, ajo do të kërkojë një referendum mbi këtë çështje. Në rastin tjetër, do të mbështetet te Gjelbrit Skocez për ta arritur atë.

Sidoqoftë, vetëm Londra mund të autorizojë një zgjedhje me rezultat detyrues. Vendosmëria e partisë SNP mund të përplaslet në muret e Pallatit të Westminster-it, garantues i sovranitetit britanik. Kryeministri Boris Johnson – triumfi i të cilit në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2019 nxiti flakën e ndjenjës së pavarësisë përtej ‘Murit të Adrian-it’ – kishte deklaruar se pas referendumit të mbajtur në vitin 2014, vendi nuk do të mbajë zgjedhje të reja në lidhje me këtë çështje para dyzet viteve.

Nga njëra anë, pra, kemi SNP dhe një mori partish më të vogla – të Gjelbrit, Partia Socialiste Skoceze (SSP) – si dhe organizatash si Fushata për Pavarësi Radikale, ekstrem e majtë, ose koalicioni Yes Alba. Në fushën e kulturës, artistët dhe shkrimtarët sjellin një dozë glamuroze, madje edhe elegancë kontestuese, në manifestet gri të partive politike në favor të pavarësisë. Tematika gjithashtu dominon në rrjetet sociale si dhe në mediat alternative. Një e përditshme, The National, filloi të botohej pas referendumit të vitit 2014 nga kompania amerikane NewsQuest për të përfutur nga një treg në rritje.

Në anën tjetër, kemi qeverinë britanike dhe partitë kryesore të vendit që nuk kanë asnjë përgjigje tjetër ndaj gërryerjes së legjitimitetit të tyre në Skoci përveç përkujtimit të vazhdueshëm të sovranitetit kushtetues të Parlamentit. Konservatorët, laburistët dhe liberal Demokratët po luftojnë për votuesit “unionistë” gjithnjë e më të pakët duke premtuar se do të kundërshtojnë një referendum të dytë, pavarësisht nga rezultati i zgjedhjeve të 6 majit. Trendi në favor të mbajtjes së Skocisë në mbretëri është i dobët kur bëhet fjalë për përafrimin e organizatave që e drejtojnë atë; dhe akoma më keq, kur përpiqet të afrohen njerëz të famshëm të tjerë përveç autorit J. K. Rowling. Skepticizmi tradicional i shtypit për pavarësinë tani kompensohet me përbuzjen ndaj Brexit-it dhe ndaj qeverisë së Z. Johnson. Edhe BBC-ja (British Broadcasting Corporation), e cila gjatë zgjedhjeve të vitit 2014 kishte anuar kundër pavarësisë, kritikohet nga unionistët, që e konsiderojnë si tepër të afërt me SNP.

Ndër ankesat e tyre: mënyra sesi kjo media e trajton kryeministrën skoceze Nicola Sturgeon (SNP), menaxhimi i krizës Covid-19 i të cilës është plebishitar nga administrata e saj. Popullariteti i zonjës Sturgeon i shpjegon në masë të madhe sukseset elektorale të partisë SNP. Krahasoni i stilit të saj të thjeshtë dhe teknik me nacionalizmin e çrregullt të

Z. Johnson ka nxitur mbështetjen për pavarësinë gjatë pandemisë.

Nuk ka « plan B »

Prandaj dinamika duket e favorshme për ndarjen. Kjo sikur e vërteton strategjinë gradualiste të miratuar nga udhëheqësit e njëpasnjëshëm të SNP që nga vitet 1990. Kjo dinamikë synonte të manovronte brenda institucioneve të Shtetit Britanik, duke kryesuar Parlamentin e parë skocez, në vitin 1998, pas decentralizimit (devolution of power) që ishte votuar një vit më parë, dhe pastaj duke përdorur aparatin administrativ për të treguar se vendi mund të qeveriste vetë. Atëherë parashihej se dalja e Skocisë do të çonte në kaos dhe në humbjen e totemëve aq të dashur për një pjesë të popullsisë. SNP gjithmonë është përgjigjur se një Skoci e pavarur do të kërkojë të bashkohet me Bashkimin Evropian (megjithëse Madridi padyshim do ta kundërshtonte atë për të mos inkurajuar separatistët katalanas), do ta ruajë valutën ‘paund sterlin’, do të mbetet ‘pjesë e kurorës’ dhe anëtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO).

Analiza gradualiste ka qenë gjithmonë që një akumulim progresiv i legjitimitetit zgjedhor përfundimisht do ta detyronte Londrën të pranonte kërkesat e SNP. Një logjikë e përforcuar nga vendimi i kryeministrit konservator David Cameron (2010-2016) për organizimin e një referendumit në vitin 2014. Në një kontekst ku pavarësi duket shumë më i popullarizuar, Londra megjithatë mund të hezitojë para se të përsërisë bastin. Gjasat e refuzimit të saj mbështesin idenë se Skocia është e margjinalizuar dhe e poshtëruar brenda unionit; por gjithashtu nxiti kritikë të gradualizmit.

Disa udhëheqës të SNP (dhe nganjëherë anëtarë të zakonshëm) nuk hezitojnë të denoncojnë disiplinën e pacipë për të cilën njihet kjo parti. Në janar të vitit 2021, Z. Kenny MacAskill, një nga dyzet e shtatë anëtarët e partisë në Parlamentin e Westminster-it, kritikoi refuzimin e zonjës Sturgeon për të diskutuar një «plan B»: të ngritet padi kundër Londrës, të organizohet një referendum pa miratimin e saj, apo edhe të shpallet pavarësia në mënyrë të njëanshme. Por diskutimi i një strategjie më radikale para se të fitonte zgjedhjet e majit do të komprometonte reputacionin e fituar me zell të SNP si një parti e qëndrueshme dhe që nuk dëshiron të merr vendime të rrezikshme. Zonja Sturgeon e ka të qartë. Pjesa më e madhe e mbështetjes që gëzon ajo buron nga ndjenja e përbashkët se nacionalizmi anglo-britanik e kërcënon më shumë stabilitetin sesa nacionalizmi skocez.

Për më tepër, lëvizja independantiste po kalon një krizë të madhe, siç e ilustron konflikti i hapur midis znj. Sturgeon dhe paraardhësit të saj, z. Alexander Salmond. Jo përkundër sukseseve të saj, por për shkak të tyre. Në rrafshin strategjik, gradualizmi bën mrekulli në formësimin e një bazeje sociale të favorshme për projektet e saj. Por basti i tij mbi legjitimitetin zyrtar zgjedhor është edhe thembër e Akilit: pa leje nga Londra, është e pamundur të kthehet mbështetja që gëzon për ndryshime politik. Po kështu, respektimi i përpiktë i rregullave, ligjeve dhe procedurave të përfshira në këtë rrugë i përjashton shumë të tjerë.

Bërja e Skocisë “të paqeverisshme“, siç po propozojnë tani disa aktivistë, për ta detyruar Mbretërinë e Bashkuar, duket e rrezikshme: që nga decentralizimi, vendi kontrollohet pothuajse ekskluzivisht nga SNP. Por kur nuk ka mundësi tjetër përveçse të presësh një dritë të gjelbërt hipotetike nga Londra, fillon të humb durimi brenda ...

Për partinë SNP, skenari ideal do të ishte një fitore e madhe në maj. Londra do të duhej t’i jepte leje për të mbajtur një referendum detyrues, rezultati i të cilit askush nuk mund ta parashikojë në këtë fazë. Disa konservatorë me ndikim kanë frikë se një refuzim nga Westminster do të fryjë më tej rrymën e pavarësisë. Por ngrohja e shpirtrave që dëshmohej nga shkëmbimet brenda SNP forcon mospranimin e unionistëve në jug: përballë një muri të pakapërcyeshëm nga jashtë, SNP mund të copëtohet, gjë që do të lehtësonte kthimin e status quo-së.

Partia laburiste (Labour), e cila ka dominuar prej kohësh politikën skoceze, po e shikon situatën me shqetësim. Derisa konservatorët mund të fitojnë shumicë elektorale në zonat elektorale të mbledhura nga Anglia, partia laburiste nuk mund të shpreson në situatë të ngjajshme. Pesëdhjetë e nëntë ulëset e Skocisë në Westminster gjithmonë kanë pasur rëndësi për këtë parti (që nga viti 1983, konservatorët nuk kanë qenë kurrë në gjendje të fitojnë më shumë se trembëdhjetë). Edhe pa fituar vota në bastionin e SNP (47 ulëse), laburistët mund të shpresojnë në mbështetjen e saj në pjesën më të madhe të programit të tyre nëse ata vijnë në pushtet pa shumicë. Në një kontekst të tillë, megjithatë, çmimi që duhet paguar do të ishte mbajtja e një referendumit ... i cili do të mund të shkakonte rënien e qeverisë. Me fjalë të tjera, kushtet që laburistët të vijnë në pushtet gjithashtu hapin rrugën për dështimin e tyre. Shpresa e fundit e laburistëve: që kundërshtimi konservator ndaj një referendumit të ri të dobësojë SNP më shumë sesa vetë unionin.

Kur e analizojmë trajektoren e krizës politike në mbretëri, duket se ka pak gjasa që mosfunksionimet strukturore të zgjidhen së shpejti. Sepse, edhe nëse laburistët mund të vijnë në pushtet pa pasur frikë nga largimi i Skocisë, kjo ndoshta nuk do ta transformon një ekonomi që ka krijuar pabarazi të thella. Horizonti i ri laburist i dizajnuar nga Z. Keir Starmer karakterizohet për momentin nga braktisja e programit ambicioz ekonomik të ish-udhëheqësit të partisë Jeremy Corbyn, nga këmbëngulja e tij për “logaridhënie buxhetore” dhe dëshira e tij për të mbytur “mosmarrëveshjet territoriale” brenda një “komisioni kushtetues“. Duke shpresuar se do të fitonte përsëri elektoratin në Anglinë veriore, Z. Starmer mbështeti marrëveshjen e Z. Johnson për Brexit. Por, duke vepruar kështu, ai përkeqësoi deficitin demokratik të denoncuar nga Skocezët: kryesisht pro-evropianë, ata de facto nuk përfaqësohen në dy partitë kryesore të mbretërisë. Kulturat e ndryshme politike të vendit po bëhen gjithnjë e më pak kompatible, derisa në Angli shfaqet një nacionalizëm militant, ndikimi i të cilit shtrihet përtej kufijve të saj.

Mbetja në Bashkimin Evropian do të thoshte, për Skocinë, zgjatja e gjendjes së ngecjes politike, kulturore dhe ekonomike e cila ka kapluar gradualisht vendin që nga themelimi i Parlamentit skocez para më shumë se njëzet vjet. Moderimi politik, i



dobishëm për ndërtimin e një koalicioni të qëndrueshëm në favor të pavarësisë, nuk sjell mjete efektive për t’iu përgjigjur rënies industriale e cila e vendos Skocinë në një situatë varësie nga sektorët e turizmit dhe financave, nga minierat e karburanteve fosile si dhe nga sektori publik i punësimit. Partia laburiste skoceze është përpjekur të ofrojë një strategji më ambicioze në këtë fushë, por ajo vuan nga unionizmi i saj kokëfortë, i cili e mban larg nga një shumicë e madhe e votuesve.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian?

E përaulizuar në rrafshin politik, shqëria skoceze po kalon gjithashtu një krizë që njihet shumë pak: shtypi kombëtar po shembet nën presionin e rrjetëve sociale ose pasi iu shitet kompanive multinacionale; shumë universitete gjenden në situatë të pasigurtë dhe janë ndër më të privatizuarit në Mbretërinë e Bashkuar. Dhe një mori organizatash joqeveritare (OJQ) – shumë prej të cilave varen nga subvencionet – janë duke u përpjekur dëshpërimisht të kompensojnë rënien e shërbimeve publike tani të shkatërruara. Sidoqoftë, këto shqetësime zënë vendin e dytë, të lënë në hije nga grindjet spektakolare midis liderëve politikë.

A do t’i jepte pavarësia pak frymë këtij peizazhi? Lëvizja skoceze e punës dhe krahut i saj parlamentar – ose ajo që ka mbetur prej saj – do të liroheshin nga ngarkesa e tyre unioniste. Ata pastaj mund të riafirmoshin rëndësinë e luftës së tyre politike dhe kulturore për klasat popullore. Por e djathta do të përfitonte nga i njëjti fenomen. Dhe perspektiva e një pakice unioniste të mundur, por prapë të konsiderueshme, që zbulon afinitet për krahun e djathtë të nacionalizmit skocez, i shqetëson progresistët.

Në rrafshin ekonomik, programi i SNP-së për pavarësi është pa dyshim neoliberal. Ai do ta vinte vendin në rrugë drejt ruajtjes së paundit sterlin dhe parashihet të paktën një dekadë të reduktimit të theksit të deficitit buxhetor – me pak fjalë, do të ishte katastrofal për popullsinë. Investimet e huaja do të rridheshin në një klasë të “kapitalistëve kombëtarë”, prijra natyrore e të cileve do të çonte në rritjen e komodifikimit të fuqisë punëtore, burimeve natyrore dhe shërbimeve publike. Për më tepër, anëtarësimi në Bashkimin Evropian – një premtim i SNP – do të kufizonte mekanikisht sovranitetin skocez. Por kritikët e kësaj ideje të “pavarësisë brenda Bashkimit Evropian”

nënvlerësojnë koston e një divorci të njëkohshëm me Londrën dhe Brukselin.

Për më tepër, një shkëputje e Skocisë do të kishte pasoja përtej kufijve të saj. Në Mbretërinë e Bashkuar, laburistët dhe e majta në përgjithësi do ta gjenin veten të konfrontuar për herë të parë me identitetin e tyre kombëtar. E privuar nga një e treta e territorit të saj, mbretëria do të kuptonte fuqinë e saj reale, përfshirë edhe në rrafshin gjeopolitik. Braktisja e fantazive të saj të “madhështisë” nuk do të ishte domosdoshmërisht një gjë e keqe. Por përballja me pabarazitë e veta territoriale dhe kulturore mund të rezultonte që një nga shtetet më të centralizuara në botën perëndimore të ndahej më tej. Shembulli skocez nuk do të kalonte pa u vërejtur në Uells dhe Irlandën e Veriut.

Në fund të fundit, pavarësia është padyshim më shumë një projekt liberal-demokrat sesa një projekt radikal. Do të ishte një mundësi për të dalur nga një regjim anglo-britanik gjithnjë e më pak demokratik dhe liberal, kriza identitare e përhershme e të cilit errëson problemet specifike – shpesh mjaft të mërzitshme – të qeverisë skoceze. Të paktën do të sqaronte hapësirën politike në të cilën e majta lokale do të duhej të vepronte. Pa e bërë domosdoshmërisht më të lehtë manovrimin.

Por ky nuk është një argument që ka shumë përkrahës. Për shumë veta në kampin pro-pavarësi – veçanërisht te ata që kanë gjetur në këtë luftë një skenë ku mund të tregojnë talentin e tyre të aktrimit radikal, pa kompromis dhe pa rezultat – ideja e zëvendësimit të një elite konservatore me një tjetër, më liberale, nuk mjafton. Ngurtësia e tyre mund të përfundojë duke forcuar bashkimin.

“Disa nacionalistë humbin shumë kohë duke u ankuar që historia e Skocisë nuk është formësuar në një kallëpe më melodramatike“, shkruante në vitin 1981 studiuesi nationalist Stephen Maxwell. Shpresa se e ardhmja duket të jetë më eksituese se e kaluara ngazëllen shumë njerëz. Por pylli i errët i identitetit kombëtar është një vend i rrezikshëm për këdo që kërkon emocione.

*Shkrimtar, Édimbourg. Bashkautor (me Cailean Gallagher dhe Amy Westwell) të Roch Winds : A Treacherous Guide to the State of Scotland (Luath Press, 2016).

TURQIA NË GJUE TINË E HAPËSIRËS POSTSOVJETIKE

Përballja ruso-turke në Kaukaz

Përmes mbështetjes së saj për Azerbajxhanin në konfliktin e Nagorno-Karabakut, Turqia ka ndërhyrë në zonën e ndikimit të Rusisë në Kaukaz. Ankara sfidon Moskën në ajër me dronë të gjeneratës së fundit. A mund të çojë kjo situatë e re strategjike në përshkallëzim? Jo domosdoshmërisht, pasi në të kaluarën të dy fuqitë kanë preferuar shpesh kompromisin se përballjen.

NGA IGOR DELANOË*

Pas Sirisë dhe Libisë, Rusia dhe Turqia u përplasën përsëri me përfaqësues në një luftë tjetër: ajo midis Armenisë dhe Azerbajxhanit në pllajën e Nagorno-Karabakut, në Kaukaz. Sferat e ndikimit dhe marrëdhëniet e pushtetit janë në zemër të marrëdhënies midis Moskës dhe Ankarasë. Ambiciet e tyre përplasen në një hark krizash që shtrihen nga Afrika e Veriut deri në Detin Kaspik, përmes Levantit dhe Detit të Zi.

Të dy vendet kanë ndërtuar një partneritet gjeo-ekonomik rreth projekteve energjetike të lidhura me sektorët e gazit dhe sektorët bërthamorë. Pjesërisht i zhytur nën Detin e Zi, tubacioni i gazit Blue Stream ka furnizuar Turqinë me gaz rus që nga viti 2003. Në janar 2020, vëllai i saj i vogël TurkStream arriti në tregjet e Evropës jugore dhe jug-lindore përmes portit turk Kiyıköy. Operatori rus Rosatom ndërtoi termocentralin e parë bërthamor të Turqisë për 25 miliardë dollarë (21 miliardë euro) në Akkuyu. Me 26.1 miliardë dollarë tregti në 2019, partneriteti tregtar zbulon gjithashtu një formë të komplementaritetit në turizëm dhe bujqësi. Ndërsa 6.7 milion turistë rusë vizituan Turqinë në 2019, ajo do të ishte importuesja e dytë më e madhe e produkteve agro-industriale ruse në vitin 2020. Më në fund, blerja e baterive mbrojtëse anti-ajrore ruse S-400, në fund të 2017, ilustroi vitalitetin e bashkëpunimit militar-industrial midis dy vendeve, fatkeqësisht për Uashingtonin. Në planin politik, Ankaraja dhe Moska kanë një këndvështrim të ngjashëm të çështjeve botërore, bazuar në mosbesimin dhe zhgënjimin e tyre të përbashkët me Perëndimin, si dhe në një interes të përbashkët për një rend botëror multipolar, i cili supozohet se do t'u mundësojë atyre që të pranohen projektet përkatëse të energjisë.

Një pan-turqizëm që predikon luftë

Sidoqoftë, ky udhërrëfyes ka nxjerrë në dritë zona fërkimi, ku mbivendosen zonat tradicionale të ndikimit të të dy vendeve. Presidenti Rexhep Tajip Erdogan kërkon të rivendosë rolin strategjik të Turqisë në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, rajone që Perandoria Osmane përfshiu në kulmin e saj në shekullin e XVII. Z. Ahmet Davutoglu, ish-ministër i jashtëm (2009-2014) i cili u bë kryeministër dhe më pas u shkarkua në 2016, e përshkruante vendin e tij si një fuqi rajonale, të aftë për të ushtruar ndikimin e tij kulturor dhe politik në shkallë planetare. Ndërsa mbronte doktrinën e “zero probleme me fqinjët”, ai përuroi një politikë të jashtme e cila mobilizoi Islamin politik apo edhe pan-turqizmin në drejtim të popullsisë turqishtfolëse të shpërndara përgjatë një harku që shtrihet nga jugu i Rusisë në Xinjiangun kinez duke kaluar nga Kaukazi (Azerbajxhani) dhe Azia Qendrore (Kazakistani, Turkmenistani, Uzbekistani dhe Kirgistani).

Në konfliktin e Nagorno-Karabakut, shprehet ky vektor – me një theks luftarak i cili ka vazhduar të afirmohet

që nga dështimi i “Pranverës arabe” në Egjipt dhe Siri, e më pas grushti i shtetit në 2016 ndaj Erdoganit. Ky i fundit mbështet hapur programin revanshist të Azerbajxhanit, një vend turqishtfolës, banorët e të cilit do të ishin pjesë e kombit turk, në bazë të konceptit “Një komb, dy shtete”, të cilin ai e ka kujtuar vazhdimisht gjatë gjashtë javëve të luftës. Nga ana e tij, z.Vladimir Putin e ka vendosur sovranitetin në zemër të projektit të energjisë për Rusinë, së cilës ai dëshiron t'i rikthejë statusin si lojtar kryesor global. Sukseset e fushatës ushtarake siriane shërben si shumëfishues i ndikimit. Për më tepër, zemra e interesave të konsideruara jetike nga Moska mbetet hapësira post-sovjetike, e perceptuar ende si një akullnajë mbrojtëse nga elitat ruse politiko-ushtarake. Sidoqoftë, në funksion të qëndrimit të miratuar nga Turqia mbi Nagorno-Karabakun, është pikërisht në këtë zonë që tani duket e gatshme të sfidojë Moskën.

Ankaraja mund të mburret me disa suksese në Kaukaz. Të mbështetur nga përkrahja e ashpër politike dhe ndihma ushtarake e Turqisë, ushtria Azerbajxhanase u rikuperua nga pjesa jugore e territoreve që shërbenin si zonë tampo për Republikën e vetëshpallur të Artsakhut, përpara se të merrte qytetin simbolik të Shushit, në zemër të Nagorag-Karabakut (shih hartën në internet). Për ta shmangur një disfatë më të hidhur, armenët pranuan, më 10 nëntor, një marrëveshje armëpushimi që i detyroi ata të evakuonin rajonet të cilat ende i kontrollonin: atë të Agdamit dhe enklavave Azeriane në territorin armen të rajonit Gazakh (20 nëntor), si dhe rajonet strategjike të Karvachar / Kelbajar (25 nëntor) dhe Berdzor / Lachin (1 dhjetor). Vetëm një korridor i gjerë pesë kilometra, nën kontrollin e Rusisë, do të garantojë kalimin në Armeni.

E përfunduar nga ndërhyrja e Moskës, marrëveshja parashikon krijimin në territorin e Azerbajxhanit të një qendre të ndërprerjes së luftimeve, të vendosur nën sponsorizimin ruso-turk (siç është rënë dakord me telefon midis presidentëve Putin dhe Erdogan në ditën e nënshkrimit të tekstit). Duke rëmbyer një post në Azerbajxhan, Turqia tani duket e aftë të projektojë ndikimin e saj në mënyrë më efektive në Azinë Qendrore turqishtfolëse. Për më tepër, do të zhvillohet një korridor i ri midis Republikës Azerbajxhanase të Nakhichevan (pa dalje në det në territorin Armen dhe Turqisë fqinje) dhe Azerbajxhanit. Kështu, Turqia do të ketë – përmes kufirit të saj me Nakhichevan – hyrje të drejtpërdrejtë në Detin Kaspik dhe rezervat e saj të çmuara të gazit në det të hapur. Me arrijten e marrëveshjes së armëpushimit për një periudhë pesë-vjeçare të rinovueshme, mbetet për tu parë nëse Ankaraja do të kënaqet vetëm me përfitimim që do të marrë. Megjithatë nuk përmendet Turqia në dokument, Presidenti i Azerbajxhanit Ilham Aliyev tha se ushtarët e tij kishin për qëllim të merrnin pjesë në forcën e ndërhyrjes – informacion i mohuar nga Kremli.

Dëshira e Ankarasë për të krijuar një



raport fuqie me Moskën edhe në hapësirën post-sovjetike duket e motivuar nga dëshira për të konsoliduar pozicionet e saj kundër Kremlinit në frontet e tjera (Siri, Libi, Mesdheu Lindor). Kjo iniciativë është për më tepër e ngjashme me një manovër jashtë rrethimit për të lehtësuar presionin që Turqia ndjen për shkak të rritjes së trupës ushtarake ruse në afërsi të saj, në Detin e Zi, në Kaukaz dhe në Levant. Ankaraja duket se nuk është më e gatshme të ndihmojë në riinvestimin ushtarak rus në Detin e Zi. Qershorin e kaluar, një aeroplan turk furnizoi me karburant një bombardues strategjik amerikan B-1B Lancer në fluturim mbi Detin e Zi, duke simuluar një sulm kundër objektivave detare. Për më tepër, nuk mund të përjashtohet mundësia që Ankaraja po kërkon të marrë bazë ushtarake në Azerbajxhan për të riekulibruar marrëdhëniet strategjike me Moskën, të perceptuara si të pafavorshme pasi Rusia mori bazat e Tartous (marinës) dhe Hmeimim (forca ajrore në 2017) për dyzet e nëntë vjet në bregdetin sirian, nën hundën e Turqisë.

Parë nga Moska, braktisja e modelit të një republike laike kemaliste, e ilustruar më tej korrikun e kaluar nga shndërrimi në një xhami të ish-Bazilikës Ortodokse të Shën Sofisë, në Stamboll, është një shqetësim. Pan-turqizmi ka të ngjarë të rindezë frikën ruse për ambiciet e Ankarasë në hapësirën post-sovjetike, ku – përfshirë në Rusi – besohet të jetojnë 120 milion folës të gjuhës turke. Moska ka frikë se instrumentalizimi i Islamit do të destabilizojë vetë territorin e Federatës Ruse – nga e cila 15% e popullsisë praktikon Islamin Sunni – veçanërisht pasi konfliktet dramatike kanë prekur Kaukazin e Veriut (Çeçeni, Dagestan) në vitet 1990 dhe në fillim 2000. Transferimi i operuar nga shërbimet turke të sigurisë nga 29 shtatori i disa qindra xhihadistëve nga Libia dhe Siria në frontin e Nagorno-Karabakut ka diçka për të ngjallur shqetësime serioze në Moskë. Në Detin e Zi dhe Detin Kaspik, Rusia nuk heziton të kërkojë partnerët e saj në delikatesë me Turqinë: anijet iraniane morën pjesë në ujërat e Kaspikut në përbërësin detar të stërvitjes ushtarake ruse Kavkaz-2020, e cila zhvillohet në fund të shtatorit. Përveç kësaj, manovrat detare ruso-egjiptiane të quajtur “Ura e Miqësisë” së pari u zhvilluan në nëntor në Detin e Zi.

Por turqit kanë një kartë tjetër në lojën e tyre: Ukrainën. Ankaraja, e cila kurrë nuk njohu aneksimin e Krimesë nga Rusia në 2014 pa miratuar sanksione kundër saj, ka zgjeruar bashkëpunimin e saj me Kievin në fushën ushtarako-teknike. Në vitin 2018, Ukraina bleu gjashtë dronë turq sulmues Bayraktar-2, të përdorura në Idlib (Siri), Libi dhe Nagorno-Karabak. Përtej kësaj blerjeje, ukrainasit dhe turqit do të kishin operuar një sinergji në këtë zonë me dronin e ri Bayraktar Akinci, i cili përfundimisht mund të prodhohej direkt në Ukrainë. Përdorimi i tij do të shkaktonte vendosjen e kapaciteteve anti-ajrore ruse, të tilla si bateritë Pantsyr, të cilat kanë provuar se janë efektive kundër dronëve turq në Siri dhe Libi. Rusia mund të mbështetet gjithashtu në mjete të lëvizshme të luftës elektronike, të tilla si radari Krasukha-4, i vendosur qartë në Nagorno-Karabak në mënyrë që t'i përgjigjet kërcënimit të dronëve turq (Bayraktar-2) dhe atyre, “kamikaze”, të prodhimit izraelit (Lloji Harop), blerë nga Baku.

Për shkak se “lufta me drone” përbën një nga të dhënat e këtij raporti të ri fuqish midis Rusisë dhe Turqisë, në këtë varg krizash të cilat mbulojnë zonën e gjerë mesdhetare, deri në ultësirën e Kaspikut të Kaukazit. Zotërimi i dronëve sulmues i jep Ankarasë një avantazh ndaj Moskës, e cila aktualisht nuk e ka këtë. Kjo është përgjigja turke ndaj sistemit të mohimit të hyrjes të vendosur nga Rusia në Levant dhe Detin e Zi, i cili e lejon atë të bllokojë hapësirat ajrore dhe detare të këtyre dy rajoneve falë teknologjisë së raketave.

Përdorimi i dronëve tregoi sukses në Idlib marsin e kaluar, kur rajoni ishte i mbushur me përplasje të dhunshme midis xhihadistëve pro-turq dhe forcave loyaliste të mbështetura nga Rusia. Gjatë këtij episodi, rusët hasën vështirësi serioze në sigurimin e mbulesës efektive anti-ajrore për akuzat e tyre të shtypura nga sulmet e dronëve turq. Falë kësaj teknologjie, Ankaraja ishte – rast përjashtues – në gjendje të sfidonte zotërimin rus të qiellit, i cili, jashtë zonës së pushtuar nga amerikanët në lindje të Euftratit, nuk kishte ndodhur kurrë në konfliktin sirian.

Që nga fillimi i marrëveshjeve midis

Putin dhe Erdogan, në fillim të viteve 2000, rusët dhe turqit zgjodhën ndarjen e dosjeve, në përputhje me realpolitikën që ata duan. Nën këtë qasje, mosmarrëveshjet e tyre thelbësore mbi Ukrainën, për shembull, nuk e kanë bllokuar të gjithë partneritetin e tyre, ndryshe nga marrëdhëniet midis Rusisë dhe komunitetit Euro-Atlantik. Vetëm kriza siriane ishte një përjashtim për një kohë, gjatë periudhës së grindjes që pasoi shkatërrimin e një Su-24 ruse nga një F-16 turk në fund të nëntorit 2015, dhe se letra e ndjesës dërguar nga presidenti Erdogan në Kremlin në qershor 2016 ndihmoi në zgjidhjen e ngërçit.

Riaktivizimi i çështjeve ngjallin zemërim (Nagorno-Karabak), vazhdimi i mosmarrëveshjeve të fshehta (çështja kurde, Qipro, Donbass, çështja e gazit në Mesdheun Lindor) dhe ekzistenca e krizave të hapura ku rusët dhe turqit marrin qasje antagonistike (Siria, Libia) të vendosin në pikëpyetje mbi zhvillimin e mundshëm të marrëdhënies së tyre. Deri në çfarë mase synohet të vazhdojë funksionimi i tyre aktual? A nuk do të tundoheshin ata të konsiderojnë një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj krizave midis tyre, siç ishte rasti në korrik 2005? Gjatë një interviste të mbajtur në Soçi, Putin dhe Erdogan thuhet të kenë rënë dakord të sigurojnë mbështetje të ndërsjellë përballë kërcënimit separatist dhe terrorist që pretendohet se përfaqësohet nga luftëtarët çeçenë për Rusinë dhe militantët kurdë për Turqinë. Me fjalë të tjera, do të kishin përfunduar një pakt mos ndërhyrje, duke lidhur problematikat e sigurisë së dy çështjeve të cilat pengojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale.

Sidoqoftë, të dy partnerët kanë përvojën që do t'i lejojë ata të angazhohen në ujdj për kompromis dhe kompensim. Pranimi i logjikës së sferave të ndikimit, ngadalësimi i Evropës në çështjet strategjike mesdhetare dhe hezitimi amerikan ndaj aventurave të reja ushtarake u siguron atyre hapësirë të lirë për të mundësuar bashkejetesën e interesave të përbashkët. Sepse, në fund të fundit, asnjëri prej tyre nuk dëshiron të kalojë në një përballje të drejtpërdrejtë.

* Zëvendës-drejtor i Observatorit Franko-Rus (Moskë) dhe profesor historie.

TEATËR

Pasolini ose refuzimi i përshtatjes

Është gjithmonë i njëjti armik që vret teatrin: borgjezia, ajo që e do veten, por që gjithashtu, më tinëzisht, ajo e cila duke u turpëruar nga vetja, prodhon një "teatër borgjez anti-borgjez".

NGA OLIVIER NEVEUX



Ibërë publik për herë të parë më 1968, me rastin e shfaqjes së tij ‘Orgji’, ‘Manifesti për një Teatër të Ri’ i Pier Paolo Pasolini ishte botuar vetëm pjesërisht në Francë. Shtëpia botuese ‘Ypsilon’ mundësuan njohjen e tërë veprës së tij.

‘Manifesti’ përshtatet në një situatë që poeti drejton dhe sfidon, pa lejuar që mbetet peng në aktualitet. Pavarësia pasoliniane e një marrëdhënie polemizuese dhe të lirë me rrethanat: kjo është mënyra se si kineasti do të mohojë tre filma viteve në vijim : Trilogjia e Jetës duke vlerësuar se “sinqeriteti” dhe “nevoja” e tij janë “robëruar dhe manipuluar” nga pushteti integruar dhe shoqëria e konsumit : trupat, erosi, që i përruronte duke i rikuperuar më vonë. Sfidat ishte gjithnjë e njëjta: të mos “pranosh të papranueshmen”, të mos përshtatesh.

Kjo vëgjuencë ka të bëjë edhe

me artin dhe konformizmin mbretëruar. Pasolini shumëzoi letrat, artikujt, esetë dhe poezi për ta shprehur. Disa gjinden në ‘Religionin e kohës sime’, që tallet ose kundërshton me forcë realizmin akademik ose “reaksionin stilistik”. “Nuk do ta gjejë paqen, kurrë”, shkruan Pasolini. “Në mua është tani i mbyllur demoni i tërbimit”.

Më 1963, ai e bëri një film-poezi të titulluar me të drejtë ‘La Rage’ (Mllef), i cili u ribotua qëllimshëm. Nga Marilyn Monroe, “e gjora motra e vogël”, tek shtypja e luftës së popullit algerian, nga kapitali i cili “ndihet i rivendosur/në momentin që mund të fillojë të korruptojë përsëri” në vjedhjen kozmike, mllefi poetik bashkon, zbulon, shpërfaq dhe madhëron.

Prapë është ajo që animon ‘Manifestin’. Sepse nëse duhet një teatër i ri, kjo është për shkak se ka dështuar teatri në fuqi: « Edhe aktori më i zakonshëm

dhe më punëtor, para publikut më të vjetër dhe më të prishur borgjez, ka ndjenjë e mjegullt të mospjesëmarrjes në një ngjarje sociale, triumfuese dhe plotësisht të justifikuar ». E reja do të jetë një ‘teatër i fjalës’, në shkëputje me dy format që triumfuan pastaj: “teatri i britmës” dhe ai i “muhabetit”, “dy produkte të të njëjtit qytetërim borgjez [që] e kanë të përbashkët urrejtjen e fjalës”. Është gjithmonë i njëjti armik që vret teatrin: borgjezia, ajo që e do veten, por që gjithashtu, më tinëzisht, ajo e cila duke u turpëruar nga vetja, prodhon një “teatër borgjez anti-borgjez”.

Këtë “teatër të fjalës”, Pasolini e definon më tepër negativisht. Por, disa vërejtje rreth aktorit, ritualitetit që duhet të shpiket, janë me koncizitetin e tyre, frymëzues. Dëshirat e Pasolinit tani me siguri pikëtakohen në disa vende të zakonshme të “poetikave” të teatrit të subvencionuar: përlësia e shfaqur e skenareve

që pretendojnë se janë vetëm në shërbim të “fjalës”, për shembull. Por ky “pasolinizëm” jeton vetëm në mostra dytësore që i anekdotizojnë fjalët e autorit.

Në fakt, Pasolini kërkon t’i shmanget filozofëve spontanë të teatrit dhe t’i kundërvihet atyre me një perspektivë më pak mistifikuese. Prandaj edhe reflektimi i tij për publikun. Ai argumenton se teatri i fjalës i kushtohet “grupeve të avancuara kulturore të borgjezisë”. Ky publik nuk dëshiron të “argëtohet” ose “skandalizohet”, sepse është i barabartë me autorin në të gjitha pikat. Pohimi është provokues, por është me të vërtetë në emër të “ideologjisë marksiste” që ai e mbron këtë pozicion: ky teatër është “i vetmi që mund t’i qaset klasës punëtore”, sepse “është i bashkuar nga një marrëdhënie e drejtpërdrejtë me intelektualët e përparuar”.

Edhe kur rezultojnë arbitrar, skandaloz ose i ekspeditiv, ky

tekst zë vend në një konstelacion shkrimesh të poetëve që kanë zbuluar teatrin, një teatër tjetër, i cili do t’ia lejonte vetes ambicien për t’u bërë sërish një “ngjarje shoqërore, triumfuese dhe plotësisht të justifikuar”.

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti “Musine Kokalari” - Prishtinë (Kosovë)

Drejtuar: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ardit Rada

Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti

Përkthimi: Lemane Muriqi, Nerimane Kamberi, Bora Deda, Belgzim Kamberi

Layout design: Josif Xhemali

Email: botadiplomatike@gmail.com

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde, Association Gunter Holzmann, Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01, Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI, président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales: Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale: Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints: Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d’édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS, Evelynne PIELLER, Hélène RICHARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN

Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON
Conception artistique: Maria IERARDI, Boris SÉMENIAKO (avec la collaboration de Delphine LACROIX pour l’iconographie)
Rédacteur documentaliste: Olivier PIRONET
Mise en pages et photographie: Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial, chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaïa SAHALI
Secrétariat: Yulija DAROUKA (9621), Sophie DURAND-NGO, attachée communication et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel: prénom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs: François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET
Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUEDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET

Relations marchands de journaux (numéro vert): 0805-050-147

Service relations abonnés
• Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr
• Depuis l’étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles, sauf accord avec l’administration
© ADAGP, Paris, 2019, pour les œuvres de ses adhérents
Prix de l’abonnement annuel à l’édition imprimée: France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3-4
Pikëpyetjet e përmbysjes së madhe ‘catch-all’,
INTERVISTOI: SHKODRAN HOTI

FAQE 4
“Heshtni!”
NGA SERGE HALIMI

FAQE 5-6
Klientelizmi dhe identitetet e trazuara në Malin e Zi,
**NGA TË DËRGUARIT TANË
SPECIALË PHILIPPE DESCAMPS
DHE ANA OTAŠEVIĆ***

FAQE 7-8
Shqipërisë i mungon një e majtë sociale,
INTERVISTOI: ARDIT RADA

FAQE 9
Votuesit e ofenduesve të tyre,
NGA MURTAZA HUSSAIN*

FAQE 10-11
Paranoja amerikane, si trashëgimi e Donald Trump,
NGA THOMAS FRANK*

FAQE 11
Shqipëria e Referendumeve të ndaluara,
NGA RESUL RESULAJ

FAQE 12-13
Serbët dhe shqiptarët kanë më shumë histori bashkëjetese sesa konflikti,
**INTERVISTOI: VUKASHIN
OBRADOVIQ**

FAQE 14
Idila midis vendeve të Gjirit dhe Izraelit,
NGA AKRAM BELKAÏD

FAQE 15
Skocia ëndërron pavarësinë,
NGA RORY SCOTHORNE*

FAQE 16
Përballja ruso-turke në Kaukaz,
NGA IGOR DELANOË*

FAQE 17
Pasolini ose refuzimi i përshtatjes,
NGA OLIVIER NEVEUX